

DR. ZOJE JAKAJ (XHOI)

GRUA

HISTORI DHE RRËFIME

BOTIMET TOENA

DR. ZOJE JAKAJ (XHOI)

GRUA

histori dhe rrëfime

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

Recensent: Miri Pepa

Imazhi në kopertinë: Meri File

ISBN 978-9928-327-20-8

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

*Dedikuar grave shqiptare, nënës sime, motrës Paola,
vajzave Xhulia dhe Oriola.*

Mirënjohje

Falënderoj miken dhe bashkudhëtaren time të zemrës, Nora Malaj, e cila ka qenë shtysa kryesore që unë të jem në tregun e librit.

Gjithashtu shkrintaren, poeten, psikologjen, Anxhela Peza, njëherësh edhe bashkautore e librit “Paraadoleshenca - sfidat e prindërimit”.

Një falënderim shumë i përzemërt i shkon mikes sime, njëherazi drejtores së Shtëpisë Botuese Irena Toçi, e cila më ka mbështetur pa fund në të gjitha botimet e mia, e pa hezitim e them që librin tim të parë kam arritur ta botoj falë besueshmërisë së saj.

Dëshiroj t’u përcjell mirënjohje të sinqerta atyre grave dhe vajzave që më besuan historitë e dashurisë dhe dhimbjes së tyre.

“I dua të gjitha gratë, pavarësisht nga mosha dhe ngjyra. Mendja njerëzore nuk mund t’i vlerësojë detyrimet që kemi ne kundrejt gruas. Por ajo na qep kopsat, na ndërron rrobat; na ndihmon për panairët fetare; ajo ka besim te ne, na tregon çdo gjë që mund t’i zërë veshi, për punët e vogla personale të fqinjëve; na jep këshilla të mira dhe të pakursyera; na fërkon ballin kur na dhemb koka; na lind fëmijët tanë, - tanët

në përgjithësi. Në të gjitha marrëdhëniet e jetës është një nderim i drejtë dhe mirënjohës ta quash gruan, bashkëshorte. Në çdo vend që ta vendosësh gruan, në çfarëdo detyre apo sëre, ajo përbën një stoli për vendin që do të zërë dhe një thesar për të gjithë.”¹

¹ Fjalimi i Mark Twain-it, “Gruaja - një mendim”, mbajtur në klubin e gazetarëve, në Washington.

Grua - histori dhe rrëfime

Ky është titulli i librit të dr. Zoje Jakajt, botuar nga shtëpia Botuese TOENA. E mora në dorë me shumë kërshëri, e nisur së pari nga ideja se përvoja tepër e veçantë e autores si drejtoreshë e Burgut të Grave, I.E.V.P “Ali Demi” - për ta quajtur me emërtimin e tij të plotë këtë institucion - patjetër që do të ishte burim reflektimesh të thella. Por edhe përvoja e saj në fushën e medias, në fushën sociale e juridike, atë mësimdhënëse, ku ka qenë gjithnjë në pozicione drejtuese, ma shtonte edhe më dëshirën për të mësuar prej këtij rrugëtimi kaq të pasur në ngjarje dhe marrëdhënie njerëzore.

Dr. Zoje Jakaj ka marrë përsipër një punë jo të lehtë: ajo e ndan veprën e saj në disa kapituj e në disa pjesë, ku në pjesën e parë zë një vend të rëndësishëm historiku i feminizmit botëror, valët e ndryshme të tij e më pas kalon në analizën e gjendjes së gruas në Shqipëri, në të kaluarën dhe sot. *Unë, shkruan ajo, nuk e kam parë të arsyeshme të përdor feminizmin si një mburojë duke shpjeguar më tej, me arsyetime të shumta se si feminizmi nuk është një armë kundër burrave, por një mjet për të arritur barazinë me burrat, në shoqëri të mbizotëruar - jo vetëm shqiptare - nga kultura mashkullore. Dhe shfaqin shumë*

interes këto pjesë të librit, të cilat janë si një uverturë ku shtjellohet ecuria e feminizmit, qoftë në botë a qoftë dhe në Shqipëri, për të hyrë pastaj në hollësi të shumta, konkretizuese, në shembuj frymëzimi, në problematika të ndryshme.

Kapitulli mbi historikun e rrugëtimit të grave në botë, me referimet që jep, mbështet idenë se sa e vështirë ka qenë kjo rrugë. Mjafton të kujtojmë episodin që na sjell këtu autorja nga shekulli i V-të, kur “Këshilli nga Makoni” u mblodh që të shqyrtonte “Të vërtetën rreth grave”. *Qëllimi për ta ishte i thjeshtë: të vendosnin nëse ato kanë apo jo shpirt. Në fund të studimit erdhën në përfundimin se të gjitha gratë kanë shpirt të prishur, janë të dënuara me mallkim të përjetshëm, dhimbje dhe qëndrim në zjarr, përveç Marisë, nënës së Jezusit. Etërit e shenjtë të ritit katolik e kanë konsideruar gruan si përgjegjëse për mëkatet. Sipas tyre, “trupi i gruas është derë për hyrjen e djallit” ndaj ajo është e mallkuar përgjithmonë. Në vitin 586, “Këshilli i të Shkathëtëve” shpalli se gruaja nuk i takon qenieve njerëzore dhe është krijuar vetëm për t’i shërbyer njeriut.*

Mëtej, në kapitujt ku analizohen situata të ndryshme të gruas shqiptare hasim emra grash të famshme shqiptare, frymëzuese për publikun, në të gjitha fushat arsim, kulturë, shkencë etj., por edhe interpretime të autores, shpjegime, përsiatje mbi arsyet e shumta të gjendjeve të caktuara. Janë gra që “kanë bërë histori” në histori, në fushat e lartpërmendura. Këtu gjejmë Teutën, Donika Kastriotin, Elena Lukrecian, Nora Kelmendin, Tringa Grudën, Dora d’Istrian,

Dhaskarina Bubulinën, Motrat Qirjazi, Paro Kitën, Urani Rumbon, Marie Çobën, Shote Galicën, Santa Angjelinën dhe të Shenjtën Nënë Terezën. Analizon edhe dukurinë e “burrneshave”, duke u mbështetur në referime edhe të autorëve të huaj që i kanë përmendur apo diskutuar, si fenomen.

Dr. Zoje Jakaj thekson se e vendos theksin mbi *feminizmin tim, për të lobuar përfaqësimin tonë dhe ndikimin e madh në shoqëri*. Ajo e bën të vetin sloganin e njohur se *Feminizmi është lufta për të mbrojtur dhe për t’i zgjeruar të drejtat e grave*. I kushton jo pak vend pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje, duke e parë nën këndvështrimin e barazisë së vërtetë shoqërore dhe të të drejtave të njeriut, nuk mund ta kuptojë zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë së sotme pa gruan në rol të barabartë në politikë, ekonomi, administrim e kulturë. Mendon se kombi shqiptar nuk mund të ngrejë nivelin e tij në të gjitha këto fusha, nëse nuk e ka gruan të barabartë dhe të emancipuar. Por, nga ana tjetër tërheq vëmendjen, se, duke folur vazhdimisht për të drejtat e gruas, shpeshherë duket sikur fitohet imunitet ndaj teorisë dhe nuk ecet përpara. Kjo pikëpamje origjinale është mjaft me interes për t’u lexuar e reflektuar në këtë libër.

I kushton rëndësi dhe thellohet në dukurinë e pabarazisë gjinore. *Pavarësisht ndryshimeve pozitive të ndodhura, shkruan ajo, nuk mund të mos pranohet se në fushën e respektimit të barazisë gjinore, si kusht i respektimit të të drejtave të gruas, ne jemi ende shumë larg standardeve europiane dhe më pas përsiatet*

mes konceptit të gjinisë, pushtetit dhe dominimit mashkullor e të mentalitetit të burrit të fortë.

Trajton dhe lidhjen biologjike, siç e quan ajo të nënës me fëmijën, pagesat e diskriminuara për të njëjtin vend pune, diskriminimi gjinor në vendin e punës, raportet mes burrave dhe grave në vendin e punës dhe problematikat e vërejtura, por nuk qëndron vetëm në konstatime, ajo sheh rrugëdalje tek arsimimi, kulturimi, pavarësia ekonomike, te konkurrenca.

Sa dhe si varet sukcesi i grave? Autorja hyn në një diskutim midis natyrës femërore dhe mashkullore, bazuar dhe në sondazhe, pyetësorë e studime të shumta. Do të nënvizoja se libri ka shumë referime që i shtojnë seriozitetin veprës, me psikologë, filozofë e sociologë të huaj e shqiptarë.

Autorja, në këta kapituj i jep rëndësi të veçantë arsimit: *Si mund të mbetet e ndershme një grua kur nuk është e arsimuar, nuk lexon, nuk ka dijeni, nuk ka kontakte me botën e zhvilluar dhe në aspektin moral vjen nën ndikimin e presionit të gjinisë mashkullore?*, thotë ajo, duke goditur kështu edhe stereotipa e paragjykitime të mbetura për inerci në lidhje me “nderin” dhe inercitë e tjera patriarkale e konservatore. Ajo lufton këtu kundër shfaqjeve sipërfaqësore shpesh të propaganduara nga mediet apo rrjetet sociale, ku vajzat paraqiten si të interesuara vetëm për modën, veshjet, parfumet e jo për jetën e vërtetë, që është shumë më e vështirë për t’u përballuar sesa bota vanitoze e reklamës.

Një kapitull që do ta quaja të veçantë është ai i periudhës së punës së autores si drejtoreshë e Burgut

të Grave, fakt që e përmenda që në krye të parathënies. Në atë periudhë, siç pohon edhe vetë, ajo gjeti atje një motiv tjetër frymëzimi për të shkruar këtë libër. *Njohja me gratë në këtë burg më ka bërë të shoh një fytyrë gruaje, që edhe kur groposet ose braktiset qëndron në këmbë e fortë, duke gjetur një motiv për të jetuar. Tek ajo nuk mbizotëron as hakmarrja, as inati dhe as ambiciet negative, por dashuria. Dashuria e vërtetë e motrës, e nënës, partneres, shoqes...*

Këtë kapitull autorja e titullon *Gruaja përtej hekurave të burgut, mes vuajtjesh dhe shpresash*. Këtu ajo analizon, si rrallëherë më parë, të izoluarën me burgim, marrëdhëniet me stafin, lehtësimin apo rëndimin e jetës së të burgosurave, atë botë të panjohur mes të dënuarës dhe rojave të saj, na qartëson për burgun dhe burgjet e sigurta si thelbësore për ta bërë sistemin e drejtësisë një armë efektive kundër krimit. Dhe më tej: *Kontributi që burgjet tona mund të japin për një reduktim të përhershëm të krimit bazohet edhe në mënyrën në të cilën trajtohen të burgosurit. (...) Aty kuptova sa vlerë ka jeta, në çdo rrethanë qofsh, të rëndë apo të lehtë.*

Duket se ky qëndrim ka qenë një fill drejtues në punën e saj si drejtoreshë e këtij institucioni. Mjafton të shohim letrat që gratë e burgosura i dërgonin, për të kuptuar se me sa përkushtim dhe përgjegjësi e kishte konceptuar dr. Zoje Jakaj punën që i kishin ngarkuar.

Në libër ne shohim se si para syve të drejtoreshës shpërfaqen jetë të munduara, të dhunuara, ku çdo lot ishte një “thirrje dëshpëruese për shpëtim”. *Rehabilitimi i tyre, thotë autorja, ishte një dramë*

më vete, pas lirit. Dhe këtu ndeshemi në një problematikë të njohur prej vitesh: që këto gra kanë shumë vështirësi për t'u integruar në jetë, për t'u pranuar nga familjet e tyre, për t'u strehuar etj. Vërtet, ky kapitull i jetës së grave të izoluara, pranë të cilave autorja ka qëndruar me vite dhe është përpjekur t'ua lehtësojë sadopak vuajtjen, është emocional, por edhe të shtyn të mendohesh për plagën e dhunës në shoqërinë tonë.

Dhe, më tej kemi një kapitull të tërë për dhunën psikologjike, fizike, shtëpiake, e seksuale në vendin tonë. Analizë të situatave, të motiveve, të mjeteve të mbrojtjes, të legjislacionit etj. Dhuna ndaj gruas, thyerja e heshtjes, shkaqet historike, kulturore, e shoqërore - i gjejmë shumicën këtu. Treguesit e lartë për dhunën, pasojat te gratë - janë tema që autorja i shtjellon me gjerësi dhe me detaje.

Me interes janë edhe kapitujt për “Biologjinë e trupit femëror”, gjithnjë me referenca të shumta, mbi “Teorinë mitër të inferioritetit femëror”, mbi fiziologjinë e aparatit gjinor femëror, seksualitetin, etj. Më tej vazhdohet me martesën, bashkëjetesën, familjen, mëmësinë, depresionin post-partum, mbi dashurinë, mbi lidhjet pasionale, pra me tema të qenësishme për gratë dhe vajzat, të cilat në këta kapituj, që janë të bazuar në studime serioze, do të gjejnë përgjigje, diskutime, këshilla e përsiatje mbi shqetësimet apo pyetjet e tyre.

Një kontribut që duhet përmendur e që ka rëndësi të madhe në këtë libër, janë edhe përfshirja e paketës së ligjit mbi barazinë gjinore, të ligjit mbi punësimin,

për shmangien e diskriminimit gjinor në vendin e punës, etj. Për këdo që dëshiron të ketë material të tillë të përzgjedhur e të dobishëm, të nevojshëm e real, këto paketa ligjore janë sjellë këtu nga dr. Zoje Jakaj edhe si një përvojë pozitive e luftës që shoqëria shqiptare ka zhvilluar për barazinë gjinore dhe për rolin e gruas në të.

E përgëzoj dr. Zoje Jakajn për këtë kontribut shumë të rëndësishëm që i jep grave dhe vajzave, shoqatave që punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës, për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, por edhe të gjithë shoqërisë, për të ditur se ku ka qenë, ku ndodhet sot dhe se çfarë problemesh të tjera ka përpara, për t'i përballur.

Diana Çuli

Ndjesi mbi idenë e këtij libri

Meqenëse shquhem për natyrë mjaft dinamike dhe energjike, që fle pak orë, të shkruaj gjithmonë ka qenë një nga pasionet e mia të fshehura dhe fare pak miq e kanë ditur këtë sekret timin. Kisha drojë të thosha se edhe unë mbush plot e përplot letra nëpër shtëpi, në zyrë dhe punë - ndjesi, mendime, kritika - një botë shkrimesh nëpër fletë të ndryshme. Tani, në një moshë më madhore, e pjekur dhe e bindur për atë çka dua të përcjell, vijmë edhe botimet e mia. Për këtë libër kam punuar disa vite. Shumë më përpara se të emërohesha drejtoresha e Burgut të Grave. Por ky paska qenë viti i shënuar për këtë libër.

Çdo vajzë kërkon të jetë shëmbëlltyra e nënës së saj - e bukur, e mirë, e devotshme, gjithësia për të. Unë pata fatin që linda nga një grua e fortë burrneshë, pa pasur lot në sy... Në fshehtësi e kam përvetësuar modelin e saj. Sigurisht që zgjodha t'i ngjaj nënës sime e këtë e kuptoj sot, që jam nënë e dy vajzave të mrekullueshme, Xhulias psikologe dhe Oriolës - këngëtare lirike, fotomodele e famshme në Shqipëri dhe jashtë vendit, me të cilat kam arritur kulmin e të qenët grua. Brenda meje jam plotësisht e përmbushur e me shumë fat se pas këtij produkti të vyer, sytë e mi do të rrugëtojnë gjatë gjithë jetës sime.

Në jetë jam frymëzuar nga shumë gra të arrira, qofshin këto të njohura për publikun apo jo, nga të cilat kam mundur të marr më të mirën e tyre, një vlerë a një cilësi, e cila vërtet të ndryshon. Ja një moto e imja: *Të rekrutosh cilësitë pozitive, të shohësh gotën gjysmë plot - shumë buzëqeshje do të lindin në fytyrë, e mjedisi ku do të qëndrojmë do të jetë më i këndshëm.*

Me këtë libër nuk dua të shpreh diskriminim ndaj burrave dhe as që ata qëndrojnë “më poshtë se ne”, por dua të sjell në vëmendjen tuaj se si e ka evoluimin e saj gruaja në Shqipëri, në një vend të vogël, ku bëmat e saj janë shumë të mëdha dhe se figura e gruas ka meritat e veta qysh herët në krijimin e këtij shteti, për atë që ka përcjellë te ne. Jam munduar shumë të vendos theksin mbi feminizmin tim, për të lobuar përfaqësimin tonë dhe ndikimin e madh në shoqëri. Nuk e kam parë të arsyeshme të përdor feminizmin si një mburojë, sepse... jam lodhur që në të shumtën e rasteve të përfaqësohem nga disa të tilla, që kanë veshur poltronin dhe kanë zhveshur moralin, të tillë nuk e dua feminizmin.

Nuk e dua feminizmin që të bëj femër mashkullin tim, kjo e zhvesh plotësisht burrërinë e tij dhe më bën të ndihem vetë më mashkull. Sot jam në moshën ku të gjithë janë shprehur se është kulmi i eksperiencës jetësore, mund të japësh shumë dhe ke mundësinë vetëm të veprosh me mend në kokë, jo si më parë, me shumë gabime e mësim. Ne jemi shumë të bukura në format tona ku askush tjetër nuk mund t'i bëjë më bukur sesa ne. Më pëlqen të kujdesem jashtëzakonisht shumë për veten, po me të njëjtën dëshirë do të bëja

edhe ëmbëlsirën e tij të preferuar në kuzhinë, me flokët e mbledhur lart, pa grimin e përditshëm dhe mbi të gjitha me shumë dashuri.

Me këtë libër nuk dua të përcjell idenë se feminizmi te ju është një ikonë për gjininë tjetër, ku mund të bësh një kukull prej plastike që, në fund të fundit, “investitorët” i ka burra. Asnjëherë nuk e kam dashur gjendjen ku thuhet pikë për pikë se çfarë është feminizmi, por jam më se e bindur se asgjë nga këto nuk përputhet me konceptin që unë kam. Ne i qëndrojmë ende fort asaj shoqërie ku vetvetiu i “tkurrim” vajzat, duke u thënë përherë, “ok duhet të kesh ambicie, por kjo ambicie të mos i kalojë kufijtë”, “duhet të jesh e suksesshme, por jo aq sa të jesh e frikshme për njeriun” dhe duke qenë se jemi gra... aspiratat tonat duhet të përfundojnë në kërkimin e të duhurit për martesë. Një kultivim i ndryshuar, por që ende mbart në thelb traditën e fortë arkaike të mentalitetit tonë. Akti i martesës, mund të jetë një burim i gëzimit, dashurisë dhe mbështetjes reciproke, por pse nuk jemi shoqëri e barabartë për të dyja gjinitë, kur vjen puna për t’i edukuar djemtë në të njëjtën formë? Shoqëria jonë rrit vajza, që shohin njëra-tjetrën, duke i shoqëruar me shembuj: e shikon ajo mori një “alamet djali” që ia plotëson të gjitha kushtet ose ajo “e ka vënë shapkën mbi sy mi motër se u rehatua”... Popull i varfër në sofër dhe i varfër në mendje. Këto idioma, më bëjnë më pak feministe të këtij lloji.

Duke qenë një periudhë drejtoreshë e Burgut të Grave, I.E.V.P “Ali Demi”, gjeta një tjetër pjesë të

plotësimit të frymëzimit mbi shkrimin e këtij libri. Njohja me gratë në këtë burg më ka bërë të shoh një fytyrë gruaje, që edhe kur groposet ose braktiset qëndron në këmbë e fortë, duke gjetur një motiv për të jetuar. Tek ajo nuk mbizotëron as hakmarrja, as inati dhe as ambiciet negative, por dashuria. Dashuria e vërtetë e motrës, e nënës, partneres, shoqes. Gruaja dashuron gjithmonë bukur, në formën që ka bërë gjithë botën të flasë për të.

Jam një feministe e teorisë së barazisë politike, ekonomike dhe sociale, në emër të të drejtave dhe interesave të përbashkëta të gjinive.

*E barabartë mes burrave, por jo kundër burrave!
Dashuroj burrat! Po ata të vërtetët ama...*

Disa përsiatje për barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në politikë

Për t'u bërë vërtet e lirë, një gruaje i duhet të hedhë zinxhirët e formës aktuale të familjes, të cilat janë të tejkaluara dhe shtypëse. Për gratë, zgjidhja e çështjes së familjes, nuk duhet të jetë më pak e rëndësishme sesa arritja e barazisë politike dhe asaj ekonomike.

Alexandra Kollontai (revolucionare ruse)

Sa shumë flitet për emancipimin e gruas në mbarë botën... Po realisht ku jemi ne si vend? Nëse i hedhim një vështrim të shkuarës, krahasuar me të sotmen, na lind pyetja: a jemi më pranë zhvillimeve pozitive apo kemi pësuar regres për sa i përket emancipimit të gruas? Në ditët e sotme të flasësh për të drejtat e gruas është një gjë aq e përditshme jetese, saqë shpeshherë, duket sikur kemi fituar aq shumë imunitet ndaj këtyre teorive dhe nuk po risjellim asgjë të re që t'i mbrojmë gratë realisht. Në parim, ne si shoqëri po jetojmë një kohë lulëzimi për gratë, sepse ato gjithmonë e më shumë po fitojnë të drejta, gjithashtu, kanë më shumë rol dhe integrim në jetën sociale, politike dhe ekonomike. Përmes kulturës sonë, vetëdijes dhe ekzistencës së pabarazisë gjinore (që na e dëshmon

historia) mund të kuptojmë se emancipimi i gruas është i domosdoshëm jo vetëm për të mirën e saj, por edhe të shoqërisë në tërësi. Në Shqipëri gjinia femërore si më parë ashtu edhe sot, nuk ka qenë në kushte shumë favorizuese, paçka “make up”-it, që është hedhur mbi të, për të mbuluar vrangat e shumta që ia ka shkaktuar koha. Sot, në Shqipëri gruas së zakonshme i duhet të përballet me rritjen e fëmijëve, me punët dhe kujdesin e shtëpisë, kështu që i mbetet shumë pak kohë për përpjekje dhe arritje për një karrierë të suksesshme. Sigurisht, gra nga familje mbi mesataren ekonomike, mund t’i lejojnë vetes luksin për të pasur një grua ndihmëse - stil krejt borgjez - për të gatuar a pastruar, por ky nuk është realiteti i masës. Ndaj edhe emancipimi i gruas në Shqipërinë postkomuniste, është përqendruar veçse në një rreth të ngushtë grash, rreth atyre që iu përkasin klasave ekonomikisht më të pasura. Masa duket se është mjaftuar me fitimin e asaj pak lirie në të shprehur, në të veshur e ndonjëherë në të vepruar dhe nëse kanë pak fat... edhe mund të marrin vendime për veten e tyre, si edhe të të pasurit rrjete sociale, që sot janë kthyer në trend, por që jo pak herë grave u kanë shkaktuar probleme.

Është e një rëndësie parësore, që të ndodhë dhe duhet domosdo të ndodhë, ndarja me modelin e familjes patriarkale, pra sot pesha dhe përgjegjësitë e familjes duhet të bien mbi të dy bashkëshortët, duke i çliruar të dy prej modeleve të paracaktuara gjinore. Pavarësisht të gjitha përpjekjeve që janë bërë, politikave zbutëse që janë ndërmarrë apo

edhe strategjive kombëtare si edhe rekomandimeve ndërkombëtare, fatkeqësisht, sot në Shqipëri, debati mbi emancipimin e gruas edhe kur ndodh, mbetet një debat shterpë me tone dhe ngjyra krejtësisht të porealizueshme, duke qenë se kufizohet në dhënien e të drejtave dhe lirive politike grave të shtresës së mesme, që jetojnë në mjedise urbane, duke lënë thuajse krejtësisht jashtë gratë e zonave rurale dhe të shtresave më pak të privilegjuara. Emancipimi dhe vlerësimi i drejtë i femrës lidhet ngushtë (më tepër është tregues) me zhvillimin e shteteve, shkallën e kulturës së popullit, të zhvillimit të tij. Por në amullinë e zhvillimit progresiv apo regresiv, të vendit tonë, edhe emancipimit i gruas disa “ia kanë dalë”, duke prekur edhe botën e politikës shqiptare, por gjithnjë kanë mbajtur ligjëratat të paracaktuara nga kryetarët. Më tepër kjo arritje është shkak i artikullimit mes përparësive të vendosura nga ndërkombëtarët sesa nga vullneti i përbashkët i gjinisë mashkullore, i cili nuk ngurron ta shprehë haptazi, sapo t’i jepet mundësia, se çfarë pozicioni realisht do të donte t’i caktonte gruas në shoqërinë tonë.

Mundësitë e barabarta për pjesëmarrje në politikë janë çështje të të drejtave të njeriut dhe nuk mund të jenë të kuotizuara si për të nxjerrë në pah shtresën sociale të marginalizuar. Në historinë e zhvillimit të demokracisë së vendit tonë, veçanërisht gjatë viteve të fundit, është dëshmuar se prania e grave në institucionet vendimmarrëse ka përmirësuar cilësinë e qeverisjes; ka dëshmuar një konsistencë të fortë politike duke theksuar se pjesëmarrja e barabartë

është e rëndësishme për të pasqyruar interesat e grave në mënyrë të qartë e të drejtë në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Gratë në politikë nuk janë përfshirë për “t’u ngritur në revoltë” kundër burrave, e as për t’u përqendruar vetëm në çështjet për gratë dhe fëmijët. Përkundrazi, ato duhet të tregojnë qartazi vizionin e tyre se janë pjesë aktive në trajtimin e problemeve të politikës mbarëkombëtare, sigurisë e integritetit duke fituar identitet më të gjerë përfaqësues.

Është e dukshme se gratë shqiptare e rrëzojnë shpejt mitin, sipas të cilit vetëm burrat kanë mundësitë dhe cilësitë e duhura për përfaqësim, ndaj edhe përfaqësimi i tyre në politikë duhet të lihet në dorën e tyre nëse do të duam që realisht të kemi progres si shoqëri në tërësi apo edhe të krijojmë një tjetër kulturë me qasje më pozitive ndaj asaj çka shoqëria vetë prodhon e kërkon. E nëse shoqëria gruas i atribuon më shumë të drejta, por dhe e vendos në kushte të barabarta konkurrence, në këtë vend disi maskilist, ju siguroj që ato janë të afta të përmirësojnë jetën politike me “nikoqirllëk”, ashtu sikurse shumica prej tyre rregullojnë familjen dhe gjithçka që i rrethon e bëjnë me një rregullsi të admirueshme, gjë që është e pamundur të realizohet nga burrat, por për fatin tonë jo të mirë ende kuotat, drejtimi dhe përfshirja në jetën politike dhe akademike varet më së shumti prej burrave, ndaj një apel kam për gratë:

Jepini me shumë mbështetje njëra-tjetrës dhe edukoni e rrisni djem që të respektojnë motrën, shoqen dhe nesër bashkëshorten e miken, në mënyrë të tillë, që të shtrojmë ca shina të drejta për të ardhmen më të mirë të gruas shqiptare.

KAPITULLI I

1.1. EVOLUIMI I KONCEPTIT MBI GRUAN SHQIPTARE

Çdo libër me mbishkrimin *gruaja*, do të ngjallte një interes të lartë për të zbuluar misteret e mëdha që ajo gjithmonë ka fshehur në vetvete. Njerëz që kërkojnë të dinë më shumë rreth natyrës së femrës, të kësaj brishtësie ku e gjithë bota edhe pse e ka shtypur e shkelur, ka përfunduar duke u gjuhëzuar në këmbët e saj. Është nderuar me përlësi për qenien e saj, për ndryshimet e mëdha që i solli botës, për gjigantët që ajo vetë i lindi, duke i latuar ëmbël me gjirin e shpirtit. Një potencë që sjell jetë, një qenie e prodhuar për të dhënë dashuri të pashtershme. Një fuqi e frikshme e burrave, një burrneshë e shtetit shqiptar. Luaneshë e luftës, guximtare e sfidave, ngjarjeve historike, fitimtarja e shumicës së maratonave në jetë...

Mendimtarë të ndryshëm në botë kanë arritur gjithnjë në konkluzionin, se gruaja duhet vetëm dashuruar dhe jo kuptuar e kjo duhet përvetësuar para së gjithash. Shumë njerëz në jetë kanë hequr dorë për të folur për të, sepse e shohin si një enigmë, fundin e së cilës s'ka mundur ta gjejë askush. Po kush është roli i vërtetë i gruas shqiptare në ditët e sotme në shoqërinë tonë? E tjetërsuar prej shekujsh kjo shoqëri

ende mbetet konservatore ndaj fenomenit *femër*, ndaj fenomenit të të qenët *grua*. Çfarë pengesash has ajo në jetë? A mund të flasim për një barazi për sa i përket pozicionit në shoqëri, po në aspektin profesional? Gratë, falë vendosmërisë së tyre të pareshtur, janë të parat që ndërtojnë jetën fuqishëm. Punojnë më shumë, ëndërrojnë më shumë, kanë dy zemra - një në kraharor e një në mendje, dashurojnë më tepër, krijojnë më bukur. Si pjesa më pak e shtrembëruar psikologjikisht, pjesa më jetësore dhe më elitare njëherësh, gratë, kanë meritën e pazëvendësueshme që të jenë katalizatori i vetëm social në një shoqëri ku situatat janë në tranzicion, kushtëzim e shumë të tjera si këto. Psikika e gruas në vendin tonë është e shtypur nga burri, i cili e “gënjeu”, e bëri skllave të tij, e shndërroi në qytetare të dorës së dytë. Sigurisht që nuk dua të them se ka qenë burri ai që qëllimisht e ka bërë këtë gjë ndaj gruas. Kjo është e ruajtur vazhdimisht në evoluimin e vetë qenies njerëzore, e këtu do të bëja më shumë të pranishme fenë, e cila e ka përjashtuar gruan dhe e ka vendosur në pozicionin e dytë të gjinisë përfaqësuese, por edhe historianët ndoshta, luftërat, vetë politika, pra secili në mënyrën e vet duke e harruar e përjashtuan.

Një thënie profetike thotë: “Gruaja është krijuar nga brinja dhe nëse do të mundohesh ta drejtosh me forcë do ta thyesh”.

(Brinja ka domethënie e brishtësisë)

Unë jam grua dhe sigurisht që çdo përshkrim apo pohim i imi në këtë libër do të vijë si optika e syrit të një gruaje. E theksova këtë pasi mendoj se vetëm gratë e parapërcaktojnë më shumë gjininë e tyre. Burrat, që mund ta bëjnë këtë, janë ata që mbartin një pjesë të kompleksit të tyre për të zhvilluar gjininë e tyre edhe më gjerë, për shkak të thurjes së legjendave “trimërore”, pa të cilat ai ndihet i trembur dhe i pasigurt. Ne e pohojmë gjininë tonë për të vënë në pah elementet e thënies profetike që përmenda më lart.

Në ditët e sotme të flasësh për të drejtat e gruas është bërë një mënyrë e përditshme jetese, saqë shpeshherë duket sikur kemi fituar aq shumë imunitet ndaj këtyre teorive saqë, për sa i përket këtij aspekti, nuk po risjellim asgjë të re, për të mbrojtur gruan shqiptare. Mediat tona, me lajme të bujshme të kronikave të zeza, duke pasqyruar një realitet të dhimbshëm për ditët e sotme, në njëfarë mënyrë kanë “zaptuar territore” duke e bërë fenomenin femëror një ndër temat më bashkëkohore në trojet shqiptare, por dhe me përmasa botërore. Të lindesh femër shpesh konsiderohet si fatbardhësi, kurse në kohët më të hershme ishte vetëm një fatkeqësi.

Në retrospektivën e shumë shekujve më parë, në Romën antike dhe në Greqinë e lashtë, gruaja nuk kishte asnjë të drejtë. Babai mund t’ia shiste vajzat e tij kujtdo që të dëshironte, kurdo që kishte nevojë, mund t’i jepte hua ose t’i mbyste si në tragjeditë greke, sipas dëshirave të tij. Kështu pra, gruaja nuk

kishte asnjë të drejtë si qenie njerëzore. Para burrit nuk kishte asnjë të drejtë pronësie (të mos flasim për intelektin), ajo nuk bënte asnjë vizitë ose udhëtim të shkurtër, qoftë edhe për nevojat e saj personale.

Kalvari i fatkeqësive, që ndër shekuj ka ndjekur gratë në vendin tonë, shkon edhe më tej - poligamia e detyruar nga bejlerët e “famshëm” të kohërave të ndryshme. Disa të tjerë e blinin nusen me napolona ari e në shumë raste, nëse gruaja e parë nuk bënte fëmijë, ishte po ajo që do të zgjidhte bashkëshorten e dytë të burrit për të bërë fëmijët, që ajo nuk mundi dot kurrë. Sjell në kujtesë një fatkeqësi vdekjeje përpara tri viteve kur më ra rasti të isha pjesë - isha pranë me dy gratë e një burri. Mendoj se ligjërisht me njërën mund të ishte i celebruar, gjithsesi nuk u mora më thellë me këtë histori sesa me faktin që isha ulur pranë dy grave që i përkisnin një burri.

Në Greqinë e lashtë nuk ekzistonin martesat e zakonshme. Grekët jetonin në grupe dhe fëmijët nuk e njihnin nënën e tyre. Poligamia nuk ishte diçka e zakonshme, por çdo njëri prej burrave, sipas gjendjes ekonomike, mund të mbante në shtëpi një numër të caktuar grash, jashtë martese. Me një fjalë, gruaja nuk kishte një status juridik dhe burri i martuar me të mund ta falte si dhuratë ose ta jepte hua te një tjetër burrë: *a thua se kishte një afat skadence për të!* Ajo mbahej si pronë, ashtu siç mbaheshin sklllevërit dhe kafshët, që përdroreshin për nevoja të ndryshme, e, në të shumtën e rasteve, për të argëtuar dhe kënaqur egon e tyre mashkullore.

Fillesa të epokës së lëvizjeve feministe

Lëvizje feministe quhen lëvizjet që përpiqen për të drejtat e grave, për të drejta të barabarta mes qenieve njerëzore. Sipas historianëve perëndimorë, historia moderne e Lëvizjeve Feministe ndahet në tri periudha:

1. *Periudha e parë* fillon në shekullin XIX - XX, e cila merrej kryesisht me të drejtën e votimit, punësimit dhe arsimimit.

2. *Periudha e dytë* fillon në vitin 1960 dhe vazhdon deri në vitin 1980, e cila merrej me të drejtat ligjore, kulturore dhe rolin e gruas në jetën shoqërore.

3. *Periudha e tretë* fillon nga viti 1980 dhe vazhdoi deri në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XXI. Edhe gjatë kësaj periudhe vazhduan përpjekjet e periudhës së dytë për të fituar të drejtat që kishin dështuar apo nuk ishin realizuar.

Termi “feminizëm” apo “feministe” së pari u përdor në Francë dhe Holandë në vitin 1872, në Angli në vitin 1890, kurse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1910.

Ajo nuk ishte njerëzore, ashtu si burri.

Në shek. V, “Këshilli nga Makoni” u mbledh në mënyrë që të shqyrtonte “Të vërtetën rreth grave”. Qëllimi për ta ishte i thjeshtë: të vendosnin ***nëse ato kanë apo jo shpirt***. Në fund të studimit erdhën në përfundimin se të gjitha gratë kanë shpirt të prishur, janë të dënuara me mallkim të përjetshëm, dhimbje dhe qëndrim në zjarr, përveç Marisë, nënës së Jezusit.

Etërit e shenjtë të ritit katolik e kanë konsideruar gruan si përgjegjëse për mëkatet. Sipas tyre, “trupit i gruas është derë për hyrjen e djallit” ndaj ajo është e mallkuar përgjithmonë. Në vitin 586, “Këshilli i të Shkathëtëve” shpalli se gruaja nuk i takon qenieve njerëzore dhe është krijuar vetëm për t’i shërbyer njeriut.

Sot nuk janë më sekret apo fshehtësi krimet, nga më mizoret, që janë bërë ndaj gruas gjatë historisë. Anglia, një ndër shtetet që sot mban siparin në mbrojtjen e të drejtave të gruas, dikur i ka masakruar në mënyra nga më çnjerëzoret. Një ndër to ishte edhe dënimi për virgjërinë. Për të ndëshkuar gratë, përdorej një mjet, i cili shërbente për të eliminuar kontaktin seksual me burrat - rripi i virgjërisë. Shitblerja e grave u lejua në Angli deri në vitin 1805 dhe çmimi i tyre ishte 5 peni. Të mendosh “kokëkuqet” - bukurinë e të cilave sot e sodisim me aq endje - shekuj më parë ishin shtriga e duheshin djegur të gjalla.

Të shumtë kanë qenë ata, që kanë studiuar për gjininë tonë, sigurisht do të flitet për to aty ku dhemb më shumë. Aty ku ka plagë ka dhe vend për të bërë ndërhyrjet e veta. Një ndër autorët më të njohur, i njohur për studimin historik të trajtimit të grave, Kahn-i shkruan në një libër të posaçëm për to: “Në Angli, në shekullin XVI, vetëm të gjalla janë djegur rreth 8 milionë gra. Duhej që të vinte viti 1850 që gruaja të konsiderohej si qytetare, ndërsa më 1882 kishte të drejtën e posedimit të pronës”.

Në Francën e Madhe, më 1586, ende diskutohej nëse gruaja kishte shpirt dhe nëse i takonte racës njerëzore. Vetëm më 1938 u shpall ligji për të drejtën e pronës dhe posedimin e llogarisë bankare, ndërsa E. Figar thotë: “Deri vonë gruaja nuk ka pasur të drejtën e votës, ishte e përjashtuar nga jeta kulturore dhe punët publike”. Deri para një shekulli, kudo në Perëndim, vendi i gruas ishte në shtëpi dhe puna më e madhe e saj ishte kujdesi që tregonte ndaj fëmijëve. Ato ishin plotësisht të varura nga burrat e tyre apo prej burrave të tjerë!... Një lloj i tillë i dhunës kishte vazhduar me shekuj!...

***Të drejtat e gruas në ditët e sotme
(shpesh të imponuara nga opinioni shoqëror)***

Ne po jetojmë një kohë lulëzimi për gratë pasi janë ato që po fitojnë gjithnjë e më shumë të drejta, gjithashtu, kanë më shumë rol dhe integrim në jetën sociale, politike e ekonomike. Edhe pse në këtë rrugë të mbarë, në kushtet e botës sonë, për fatin tonë të mjerueshëm, ende vazhdon një përsiatjeje fizike, psikike ndaj saj, keqtrajtimet e ndryshme, deri në përdhunime makabre, mbytje, vrasje: vrasje nga ato më të çuditshmet, mund të themi horrore për vendin tonë. Jam e sigurt, dhe sipas disa hulumtimeve kështu ndodh në të gjitha kontinentet, nga Azia në Afrikë, nga Australia në Amerikë, nga Europa te ne.

Statistikat tregojnë se sot mbi 4 milionë gra janë çdo vit viktime të akteve të rënda të dhunës nga të dashurit

apo bashkëshortët e tyre. Po sipas statistikave, një ndër katër gra ka shanse të bjerë viktimë e dhunës në familje. FBI-ja (Byroja Federale e Hetimeve) thekson se 30% e grave që vriten në Shtetet e Bashkuara, janë viktima të dhunës nga të dashurit apo bashkëshortët...

Edhe pse jetojmë në shekullin e 21-të, përsëri gratë janë viktima të diskriminimit në mbarë botën. Dihet se në vendin tonë *Kanuni* vazhdon të ndikojë në mentalitetin social të popullit shqiptar, për hir të së vërtetës së madhe ky *Kanun* është një pretekst për nënshtrim, sepse askush nuk e respekton e as nuk e zbaton atë. Është kthyer në një justifikim për momentin e ndodhjes së krimeve, një alibi false për të shpëtuar veten në një veprim çnjerëzor, por në anën tjetër, gratë sot dalin lirisht nëpër kafene e kjo ndoshta mund duket pak e rëndomtë. Përmendim “të drejtën” e daljes së saj në kafë, e para, sepse është në kulturën tonë të qëndrojmë në kafë dhe së dyti, kafja përbën një lloj lirie, domethënë sot nuk është vetëm për burrat, “minikuvendet” e fabulave të Çajupit. Gratë sot punojnë dhe kontribuojnë në degë të zhvilluara ekonomike. E megjithëkëtë, statusi i burrit është shumë më dominant, si në familje, ashtu edhe në shoqëri, sepse gruaja ende konsiderohet si pronë ekskluzive e burrit. Dhe nga kjo konsideratë asaj i lindin detyra specifike, të cilat ngjasojnë me ato të skllavit në kohët e lashta.

Në këto ditë, bota ka arritur të hedhë hapa gjigantë në zhvillimin e gjinisë femërore! Ajo sot gjendet në pozicione përkrah burrit që fatmirësisht mund ta

pohojmë pa hezitim. Por po të bëjmë një udhëtim në disa zona të Shqipërisë së Veriut e gjetkë, ka probabilitet për të parë shumë lloje skenash të pabarazisë ndaj gruas shqiptare, po edhe një pozitë shumë të mjerueshme të tyre!... Këto pamje, nëse nuk do të jenë fotot si dëshmi, vështirë t'i besosh.

Përmes kulturës sonë, vetëdijes e pabarazisë gjinore ndër shekuj mund të kuptojmë se emancipimi i gruas është i domosdoshëm jo vetëm për të mirën e saj, por edhe të shoqërisë në tërësi. Nëse emancipimi i saj nuk arrin në shkallën e duhur, pra barazinë e vërtetë njerëzore, mund të thuhet, pa dyshim, se në atë popull nuk ke mundur të ndërtosh skemën e duhur të një populli të zhvilluar.

Zhvillimi dhe emancipimi i gruas në shoqërinë e sotme moderne i jep një imazh shtetit, imazh që vlerësohet sipas shkallës së kulturës që ka si popull apo si komb. Gruaja nuk ka qenë në kushte shumë favorizuese ose të mira as në Shqipëri e as në Kosovë, e të mos flasim për popullatën shqiptare në Maqedoni. Në një shoqëri ku nëpërkëmbet gruaja, nuk mund të ketë familje të rregullt brenda kornizave të normalitetit. Sjell si shembull një pamje rrëqethëse të një gruaje të ngarkuar, njësoj si një kafshë, rrugëve për të transportuar dru.

A thua përse kështu? A thua se jemi akoma aq të prapambetur, saqë mendojmë se këto skena nuk i sheh njeriu? A thua se këto shfaqje, aq të tmerrshme, nuk i transmeton bota? Shkallën e civilizimit dhe emancipimin e gruas shqiptare burrat e zakonisht e

shohim me përbuzje, me nënçmim dhe si ofendim, ndërsa këto skena *miqtë tanë, në thonjëza*, me keqardhje i transmetojnë në mediumet e veta! Qoftë pasqyrimi edhe i një numri të vogël të këtyre rajoneve, në të cilat mbretëron një konstruksion i tillë i ndërtimit dhe emancipimit të gruas shqiptare, shfaqet një pasqyrë negative që në arenën ndërkombëtare reflektohet shumë negativisht, gjithashtu edhe në planin e futjes dhe përgatitjen e popullit shqiptar për integrimin në Bashkimin Europian!

Pamja e një gruaje të ngarkuar, përkrah burrit që pi duhan, një mentalitet primitiv dhe i papranueshëm për popullin shqiptar, nga njëra anë duhet demaskuar dhe gjykuar, por nga ana tjetër që të mos kemi ndodhi të tilla duhet nxitur shkollimi i gruas drejt një civilizimi dhe emancipimi europian!

Lëvizjet për emancipimin dhe integrimin e çështjeve gjinore kanë mundësuar që shtetet e pavarura (sikurse edhe ne) të bëjnë “sistemim” të ligjeve, që garantojnë barazinë e dy gjinive në të gjitha sferat e jetës, por megjithatë realiteti te ne është ndryshe pasi gruaja përsëri është e pabarabartë. Por nëse në vende si ky i yni, ku dominon varfëria, do të jetë i pranishëm faktori i shoqërisë civile dhe i organeve kompetente, atëherë gjendja e familjeve shqiptare në përgjithësi nuk do të ishte aq e mjerueshme.

Lëvizje feministe ka pasur gjithmonë në shumë vende dhe zhvilloheshin e sfidoeshin në mënyra të ndryshme, por feminizmi në Europë, në Francë dhe në SHBA mbetet model i feminizmit. Një nga

veprat më të hershme, që parashtronte ide feministe, ka qenë libri i Mary Wollstonecraft-it “Mbrojtja e të Drejtave të Grave”, i botuar për herë të parë më 1792. Kuvendi i parë mbi të drejtat e grave u mbajt në Wesleyan Chapel në Seanca Falls (Nju-Jork, 19-20 korrik 1848), ku morën pjesë mbi 300 gra e burra. Gratë formuan Shoqatën Shtetërore për Votën e Grave dhe vazhdojnë më tej aktivitetet e tyre për të drejtën e votës së tyre. Konferenca e Dytë e Gruas, e mbajtur në Kopenhagë më 1980 ishte vazhdimësi e Konferencës së Parë. Konferenca e Tretë e Gruas u mbajt në Nairobi (Kenia, 1985) mbi Strategjitë e së Ardhmes për Përparimin e Gruas. CEDAW-ja sot numëron 185 shtete anëtare, të cilat janë të obliguara që çdo katër vjet, gjatë seancave që mbahen dy herë në vit, të raportojnë për kërkesat e grave, në mënyrë që të përmirësojnë pozitën e tyre në territore të ndryshme. Gjatë periudhës së Revolucionit Francez, të vitit 1789, në Paris, dhe në disa qytete të tjera të Francës, u formuan disa klube grash të frymëzuara nga idealet e lirisë dhe të barazisë. Klubet ishin vende takimi, ku gratë përgatishnin programe politike për të drejta të barabarta në edukim, punësim dhe qeverisje. Udhëheqësja e njërit prej klubeve në këtë kohë ishte Marie Gouze, e cila më 1791 hartoi dhe publikoi një deklaratë të titulluar “Deklarata për të drejtat e njeriut dhe të qytetarit”.

Shumë iniciativa, organizime, projekte e ide feministe nga të dyja gjinitë filluan dhe u përhapën shumë shpejt nëpër botë, në veçanti në ato vende

ku zëri i gruas ishte më i vogël, ku të drejtat e saj ishin të privuara dhe shumë herë gruaja shkelej dhe diskriminohej, ndërsa përkrahje dhe ndihmë i ofrohej shumë pak. Por sfida nuk kishin vetëm gratë në Europë dhe në SHBA, por edhe në Ballkanin tonë jugor, respektivisht te ne shqiptarët, ku gruaja shqiptare në shoqëri dhe në krijimin e familjes kishte një rol tejet të vogël dhe të kufizuar. Në vazhdim do të bëjmë një elaborim në lidhje me rolin dhe sfidat e gruas në shoqërinë tonë drejt krijimit të familjes.

Mjerisht, sot në shumë krahina tonat, gruaja shqiptare nuk gëzon as të drejtën që të ulet në tavolinë me burrat. Në shtëpi shtrohen dy sofrat: njëra për burrat dhe tjetra për gratë, në raste dasmash edhe tri - shtojcë për fëmijët që të mos shihen gratë nga burrat e huaj. Në rast mysafirësh të panjohur, gruaja e çon ushqimin gjer prapa derës, sepse nuk lejohet të hyjë në *Odën e Burrave*, pasojë kjo e ritualeve (fetare islame), që kanë mbetur si relikte nga regjimi shumëvjeçar i pushtimit osman mbi trojet tona, që çoroditën mentalitetin dhe kulturën e trashëguar ilire, që ishte një shoqëri përkrah popujve të mëdhenj.

Të jetosh në një situatë të tillë në ditët e sotme nuk është aspak e këndshme, sidomos në kushtet e një vendi si ky i yni që pretendon t'i bashkohet familjes së madhe europiane. Të duash t'i bashkëngjitesh vendeve të civilizuar do të thotë të kesh një shoqëri të tillë përparimtare edhe për gruan, një shoqëri të civilizuar me të drejta të garantuara si nga njëri kah, ashtu dhe në kahun tjetër gjinor. Duhet që të

dy partnerët, ose e thënë ndryshe, bashkëshortët, të kenë të drejta të barabarta, sepse nuk mund të kesh një bashkëjetesë normale kur njëri është zot dhe tjetri shërbëtor i urdhrave dhe diktateve.

Pamje e pashembullt: një grua duke e tërhequr gomarin në rolin e një skllaveje apo një shërbëtoje, ndërsa burri i saj hipur në gomar luan rolin e zotëriut?!...

Ndryshimet, që mund t'i ndeshësh gjatë një udhëtimi nëpër Shqipëri, por edhe në Kosovë, janë të jashtëzakonshme, aq sa të shtyjnë të pyesësh veten: se sa i madh është vendi ynë? Si ka mundësi që në një vend kaq të vogël të ketë ndryshime kaq të mëdha? Një gjë e tillë ekziston edhe në vende urbane me një zhvillim ekonomik e social siç janë Tirana, Prishtina, Durrësi, Peja, Vlora, Ferizaj, Gjirokastra, Gjakova, Pogradeci etj. Në disa zona malore dhe në vende të varfra gjenden gra që nuk kanë guximin, nga frika e bashkëshortit, të heqin shamitë e kokës edhe në temperaturat e larta të verës.

Punët e zakonshme për to janë mirëmbajtja e shtëpisë, puna në arë, ushqimi dhe rritja e bagëtisë dhe *shkel e shko* edukimi e rritja e fëmijëve. E megjithëkëtë asgjë nga këto nuk konsiderohet si një punë për to - për burrat e tyre dhe për vjehrrin, si edhe për prindërit e tyre - ky është *detyrimi i të qenët grua*. Diskriminimi i gruas në Shqipëri e më gjerë nis që në moshë shumë të hershme. Kjo gjë vihet re që në shkollat 8-vjeçare, por shfaqet më shumë kur vijon shkollën e mesme. Shpeshherë martesat e vajzave

përshejtohen në moshë të re për t'iu shmangur shkollimit dhe emancipimit përkrah me burrin. Kjo është thjesht e turpshme, vajzës i gjendet burrë (me ose pa pëlqimin e saj) se duhet të krijojë familje edhe pse ajo është vetëm një adoleshente që s'e ka idenë e familjes dhe as përgatitjen për këtë hap. Edhe kjo gjendje është nën ndikimin e hoxhallarëve, që kanë ngritur kokë kohët e fundit në Shqipëri (edhe në Kosovë) me qëllim që gruaja shqiptare të mbetet e *moralshme* (e padukshme, pa kontakte, e pashkolluar, e pavlerë, si synim i një gruaje të ndershme).

Nderi i grave të familjes është pika delikate e krenarisë të burrat shqiptarë. Përveç këtyre, në vendin tonë ka edhe shumë keqkuptime dogmatike, të cilat rrisin diskriminimin gjinor. Arsimi jo i mjaftueshëm i grave (dhe kjo jo për shkak të tyre sesa për mendësinë shqiptare) apo ambiciet dhe pritshmëritë shumë të ulëta të tyre bëjnë që ato të mbeten ekonomikisht të varura prej burrave.

Lind pyetja: Si mund të mbetet e ndershme një grua kur nuk është e arsimuar, nuk lexon, nuk ka dijëni, nuk ka kontakte me botën e zhvilluar dhe në aspektin moral vjen nën ndikimin e presionit të gjinisë mashkullore?

Kështu që, duhet të jemi të përgatitur në ndjekjen e shkollimit, të kulturës dhe emancipimit në tërësi; më konkretisht duhet të ketë patjetër politika e praktika sociale e ligjore për mbrojtjen dhe nxitjen e zhdukjes së këtyre dukurive negative në shoqërinë shqiptare.

Për ligjin dhe kodet aktuale të mos flasim... ato janë në letër, sepse deri më sot nuk ka raste të ndjekura penalisht me përgjegjshmëri reale e me ndikim në shoqëri nga shteti shqiptar apo në Kosovë për gjëra të tilla! Kjo dukuri ka shumë pasoja negative, sepse kur lidhet një fat bashkëshortor pa përgjegjësi, përveçse shpeshherë mund të arrihet deri te shkatërrimi i familjeve bashkëshortore - fenomeni i divorcit është gjithnjë në rritje - pasojat janë edhe më të rënda në jetën e fëmijëve të këtyre familjeve, duke ndikuar jo vetëm në momentin kur ndodh situata, por edhe në këndvështrimin dhe mënyrën se si ata e perceptojnë të ardhmen e tyre. Le të mbetet në të ardhmen dhe të shpresojmë që brezi i ri të jetë më i vetëdijshëm për hapat që do të hedhë në procesin e zhvillimit dhe emancipimit të gruas shqiptare përkrah grave bashkëkohore të familjeve të shteteve europiane .

Në një Konferencë të largët, të Shtatorit të 1919-ës, Lenini do të thoshte se:

Të gjithë e dini, se edhe kur grave iu njihen të drejtat e plota, ato mbeten faktikisht të shtypura, sepse kujdesi për shtëpinë u mbetet atyre dhe punët e shtëpisë janë më pak produktivet, më barbare dhe më të lodhshmet që një gruaje i duhet të bëjë. ("Pravda" nr. 213)

Sikurse u përmend edhe më lart, sot në Shqipëri gruas së *zakonshme* i duhet të përballet me rritjen e fëmijëve, me punët dhe kujdesin e shtëpisë, prandaj i mbetet shumë pak kohë për përpjekje dhe arritje të një karriere të suksesshme. Sigurisht, gra nga familje mbi

mesataren ekonomike, mund t'i lejojnë vetes luksin e një gruaje ndihmëse - në një stil krejt borgjez - për të gatuar a për të pastruar, *por ky nuk është realiteti i masës*. Ndaj edhe emancipimi i gruas në Shqipërinë postkomuniste, është përqendruar veçse në një rreth të ngushtë grash, të klasave ekonomikisht më të pasura. Është e një rëndësie parësore që të ndodhë ndarja me modelin e familjes patriarkale, ku pesha dhe përgjegjësitë të bien mbi të dy bashkëshortët, duke i çliruar të dy prej modeleve të paracaktuara gjinore.

Alexandra Kollontai, një prej figurave të njohura revolucionare ruse, vuri në dukje se familja tradicionale, mëmësia dhe përkujdesi ditor i gruas ndaj fëmijëve, ishin barrë shtypëse prej të cilave gruas i duhej të çlirohej:

Për t'u bërë vërtet e lirë, një gruaje i duhet të hedhë zinxhirët e formës aktuale të familjes, të cilët janë të tejkaluar dhe shtypës. Për gratë, zgjidhja e çështjes së familjes, nuk duhet të jetë më pak e rëndësishme sesa arritja e barazisë politike dhe asaj ekonomike.

Nga një qasje e materializmit dialektik, martesë shihet nga borgjezia, pra nga ata që bëjnë pjesë në klasën më të pasur dhe të privilegjuar, si një mjet për të trashëguar pozicionin klasor dhe pasurinë e tyre. Në “Origjinën e Familjes - Pronës Private dhe Shtetit”, Engelsi argumenton se një martesë borgjeze dhe familja që e pason atë, e vendosin gruan në rolin e mjetit për të siguruar trashëgimtarë, të cilëve do të mund t'u kalohet pasuria. Në një martesë proletare

gruaja nuk e ndihmon më realizimin e qëllimit të trashëgimit, duke qenë se prona private nuk do të ekzistonte.

Mund të tingëllojë anakronik përdorimi i termit të borgjezisë në shoqërinë e ditëve të sotme shqiptare, megjithatë është ende me vend. Ajo çka ndodh sot është se figurat drejtuese, duke shfrytëzuar postet e tyre publike, sigurojnë kapitalin ekonomik dhe social për pasardhësit e tyre, të cilët avantazhohen skajshëm përkundrejt atyre që vijnë nga familje punëtorësh. Pikërisht kjo përpjekje, për të trashëguar të mirat e arritura dhe ruajtjen e tyre brenda familjes dhe rrethit të ngushtë, është kryekëput një sjellje borgjeze, e cila e siguron kapitalin qoftë shoqëror apo ekonomik, nëpërmjet publikes dhe të përbashkëtës, çka e bën edhe me të rrezikshme.

Një rast interesant, për të ilustruar modelin e familjes borgjeze, është rasti i dy politikanëve të njohur shqiptarë: të martuar, të cilët e nisën karrierën e tyre politike thuajse me të njëjtat ritme dhe sot gruaja, përveçse nuk është aktive në politikë (në mos në prapaskenë) është aktive në programacionet e pasditeve, për të folur për arredimin e shtëpisë, fustaneve dhe fëmijëve (përpos faktit se sa i pavend është reklamimi i një jete luksoze në një vend ku një pjesë e konsiderueshme jeton në kufirin e varfërisë) duke ilustruar vizualisht se si në garën politike, është gruaja ajo e cila tërhiqet për t'u kthyer në figurën plotësuese të bashkëshortit të suksesshëm.

Pra, nëse një gruaja, në një shoqëri kapitaliste, i duhet të mbajë mbi shpinë barrën e dyfishtë, të diskriminimit klasor dhe të diskriminimit gjinor, në Shqipëri, i duhet të mbajë edhe një barrë të tretë, atë të patriarkalizmit, çka e bën më të vështirë emancipimin e saj, edhe në qoftë ajo në një pozicion shoqëror të lakmueshëm.

Emancipimi i gruas mund të vijë vetëm nëpërmjet punës, duke perifrazuar fjalët e De Beauvoir-it. Por si është situata në Shqipëri? Nga të dhënat e fundit, të publikuara nga Instituti i Statistikave, rezulton se shifrat më të larta të papunësisë dallohen te gratë. Ndërkohë vihet re se ato kryesojnë punën në sektorin bujqësor, duke nënkuptuar se sa më i ulët të jetë rangi i një profesioni në Shqipëri aq më i lartë është numri i grave të punësuar në të. Në të kundërt, gratë zënë vetëm 14.6 % të posteve drejtuese në vend. Nëpërmjet punësimit, gjasat janë më të larta që gruaja të ndërjegjësohet politikisht dhe gjithashtu të reshtë së qeni apolitike, por në kohën kur gratë më së shumti në shkallë vendi janë të punësuar në bujqësi, është një tjetër tregues se si gruaja edhe kur punon, puna e saj nuk ndihmon në emancipimin e saj. E në rastet kur ajo zë një vend drejtues, ky pozicion nuk shërben si medium emancipimi, por është pikëmbërritja e procesit. (Do të qe me vend të studiohej prejardhja ekonomike e sociale e grave në drejtim për të kuptuar mbi realitetin e lëvizshmërisë sociale te gratë për të gjykuar më drejt).

Kurrsesi kjo për ta konsideruar punën në bujqësi si më pak të dobishme, por vetëm, sepse në kushtet aktuale, kthehet në një barrë që e lidh gruan me tokën dhe për pasojë edhe me shtëpinë si objekt fizik dhe dukuri. Në kushte të tilla, është e vështirë për ta ridimensionuar veten edhe jashtë mjedisit të shtëpisë, jo vetëm si nënë, apo grua, por edhe si qytetare aktive që duhet të kontribuojë në vendimmarrje dhe në shoqëri. Për ta ilustruar, jo më larg se dy a tri vite më parë ndesha një grua që shiste perime, diku pranë rrugës së “Elbasanit”, në Tiranë. Më tregoi se zgjohej çdo ditë në orën katër të mëngjesit dhe pasi kryente punët e shtëpisë, vinte në Tiranë për të shitur perimet dhe kthehej diku në mbrëmje me furgonat e rastit, në shtëpi (në një fshat më pranë Elbasanit sesa Tiranës) ku gjithashtu i duhej të gatonte për të nesërmen. Në të tilla kushte, jo vetëm që puna nuk e çliron gruan, por kthehet në një aktivitet shtypës dhe dhunues. E për fat të keq kjo është në masë! Duke jetuar gjithmonë në mes të kryeqytetit, ndodh që ndonjëherë fshin nga memoria jote se sa i dhimbshëm është realiteti përreth teje, qoftë ky realitet dhe në qytetet e tjera të vendit tonë.

Fatkeqësisht, debati mbi emancipimin e gruas sot në Shqipëri edhe kur ndodh, mbetet një debat shterpë, me tone dhe ngjyra krejtësisht kapitaliste, duke qenë se kufizohet në dhënien e të drejtave dhe lirive politike grave të shtresës së mesme, që jetojnë në mjedise urbane, duke lënë thuajse krejtësisht jashtë gratë e zonave rurale dhe të shtresave më pak të privileguara.

Tendencat më të reja këtë dhjetëvjeçar te ne, lidhur me “emancipimin” e gruas, janë shkollimi, sepse dhe ato gra të brezave të mëparshëm, që nuk patën mundësinë të shkolloheshin edhe për shkak të sistemit, kanë gjetur kurajën për t’u shkolluar në demokracinë e ditëve tona. Të shumtë janë ata, që i përkasin brezave të kaluar, të cilët po përdorin në masë një shprehje klishe “brezi aktual nuk është aq i mirë sa ata vetë”. Gjykimet më të mëdha ndodhin me gratë, që nuk i ngjasojnë aspak llojit të femrës, që shpesh paraqitet në libra, gruas tipike shqiptare “ideale” që përshkruhet nga njerëzit. Ambicia më e madhe tanimë është shkollimi, gjë të cilën gratë po e kthejnë në një domosdoshmëri të vazhdueshme duke e ndjekur atë në të gjitha etapat e kualifikimeve të mundshme, që me të drejtë e quajmë meritë se falë shkollimit është bërë i mundur angazhimi i grave në disa institucione dhe pozicione pune edhe pse një pjesë e madhe e tyre janë mjaft të reja në moshë.

Formimi profesional, i cili vijon te femrat e moshës 20-30-vjeçare ka pasuar ndryshime të dukshme në shoqëri. Si rrjedhojë edhe “objektivat” e grave kanë ndryshuar: me rritjen e moshës së martesës së tyre, më pas vjen objektivi për të pasur një familje apo dhe për të qenë prind. Kulti i qëllimeve të jetës ka ndryshuar duke vendosur karrierën të parën e më pas familjen. Këto janë synime të cilat kanë vonuar për t’u realizuar në jetën e një femre. Janë të pakta femrat që nuk janë të arsimuara apo pa një profesion. Patjetër që nuk flasim për raste përjashtimore, apo për zona të

Shqipërisë ku mungojnë institucionet përkatëse apo për ndonjë problem të theksuar ekonomik-social. Profesionet, e zgjedhura nga rinia e femrave, po sfidojnë gjininë e meshkujve.

... Ka filluar një *rebelim i grave*, të cilat gjithashtu kanë filluar të veprojnë me guxim për të thyer tabutë. Shumë prej rregullave të vendosura nga mentaliteti i kohës dhe nga kultura që vetë vendi ynë ka kultivuar, gratë e sotme i kanë sfiduar. Flasin hapur për seksualitetin e tyre dhe e nisin herët në moshë ndarjen e intimitetit, dinë të marrin çka duan dhe synojnë një jetë duke luftuar për të. Nuk stepen përballë disa parimeve, qoftë edhe për të pasur lidhje me burra nën statusin e një martese, tradhtive partneriale, të kushteve të “pamoralshme” etj. Moda është përqendruar në subjektivitet, *si e mendon dhe e ndien ti nuk e ndiej unë*. Shumë vajza, edhe pse të reja, marrin guximin për të jetuar vetëm dhe jetojnë të pavarura nga familja e tyre dhe për këtë mendojmë kështu: që, nëse një vajzë do të dalë nga shtëpia o do të jetë për shkak të ndonjë bashkëjetese partneriale, ose për ndonjë shkollim jashtë qytetit ku jeton familja. Vajzat jetojnë duke e siguruar vetë jetesën e tyre dhe e ndërtojnë jetën sipas planeve të ndërtuara nga ato vetë. Në të njëjtën kohë shikojmë një fenomen: papunësia është e madhe, rinia nuk punon, ama vetëm jetojnë - po si ndodh kjo bashkë më paragjykimet pasuese?! Dihet se një numër i konsiderueshëm i vajzave lidhen me djem në gjendje shumë të mirë ekonomike.

Tendenca e vajzave të reja është se kush ka stilin e veshjes më të mirë klasifikohet automatikisht në rininë e vajzave të bukura, por kjo nuk ka aspak lidhje me bukurinë fizike. Bukuria ka të tjera parametra, ndryshon nga këndvështrimi rinor. Pirja e kafesë në vende *trendy*, snob, ku ka njerëz me stil në veshje dhe në sjellje përqafohet shumë lehtë nga vajzat e reja, të cilat i frekuentojnë këto vende për të konsumuar kafënë, sepse pikërisht atje mund të duken dhe të njihen me njerëz me mendime moderne, jo shumë të zakonshme dhe me stil. Kultura e kafesë, te ne si popull karakterizohet me humbje të gjatë kohe nëpër lokale. Pushimet e verës së nxehtë, planifikohen të gjata dhe spontane. Vajzat e reja shumë rrallë preferojnë t'i bëjnë pushimet me familjen dhe prindërit e tyre, tradita në rininë shqiptare është me shoqërinë, ose pushime të ndara: me prindërit dhe më shoqërinë. Rrjetet sociale si *Facebook*, *Instagram* e të tjera si këto na kushtëzojnë duke na bërë të imitojmë stile veshjesh, stile jete, foto *duck-face*, etj. Nëse nuk janë pjesë e tyre, nuk janë të kohës vallë?! E në fakt përgjigjja është po, pasi është shumë e çuditshme të mos jesh aktiv në rrjete të tilla. *Jeta jote private nuk quhet më e tillë, ekziston mundësia të lindë një tjetër term për këtë.*

Gratë e reja nuk paragjykojnë më për divorcin e tyre, as që janë nëna beqare, e as për lidhjet e tyre dashurore pa statusin e një angazhimi familjar. Të paktën kjo gjë nuk është në masë për aq kohë sa po shtohet dhe numri i tyre dhe rastet janë të shumta,

përpos faktit të të qenët shumë konservator si popull. Lidhjen e tyre nuk e fshehin më nga askush, një lidhje që ndoshta nuk premtion vazhdimësi, prandaj do të ishte mirë të këshillohej rinia femërore që të mos mundohet të dalë jashtë vetes për të qenë po aq e pëlqyeshme sa dikushi, duke u munduar pa fund të imitojë atë në veshje, apo në stilin e jetës, por ta bëjë jetën e saj duke e kuptuar veten, pa huazuar të tjerë brenda saj.

Ashtu sikurse u fol gjerësisht dhe pak më lart, gruaja moderne në vazhdimësi, lëvizjet e saj për emancipim, kanë mundësuar që shtete të përparuara të bëjnë sistem të ligjeve, që garantojnë barazinë e dy gjinive në të gjitha sferat e jetës, por megjithatë realiteti te ne ka ndryshuar shumë edhe pse në shumicën e rasteve gruaja ka probleme paragjykimi dhe dhunimi, edhe këto në forma më të emancipuara.

1.2. Ç'ËSHTË BURRNESHA?

Një grua mund të duket më mirë nëse ndihet mirë nën lëkuren e saj. Këtu nuk hyjnë as fustani e as tualeti, por mënyra se si shkëlqen.

Sofia Loren

Në shoqërinë tradicionale shqiptare, madje në “segmentet” e saj veriore edhe në ditët tona, quhet vlerësim i lartë për një grua nëse asaj i drejtohesh me fjalën “burrneshë”. Ndërkohë konsiderohej dhe konsiderohet “fyerje” apo “ofendim” për një burrë nëse e krahason atë me një grua apo me gratë në tërësi. Karakterizime të tilla, që artikuloohen dendur në jetën e përditshme të shqiptarëve, tregojnë se gratë dhe burrat kanë statuse të ndryshme, madje të nënrenditura. A janë të pranishme dukuri të tilla ende sot në vendin tonë, apo janë zhdukur krejtësisht dhe kanë marrë një zhvillim tjetër në shoqërinë tonë? Ja se çfarë ndodh ende me zona të ndryshme të Shqipërisë sonë, aq të vogël, por dhe po aq të larmishme për bëmat e mëdha të grave. Një fotograf spanjoll ka fotografuar një burrneshë në vendin tonë, të cilën ia përshkruan mbarë botës kështu:

Në pamje të parë duket si një burrë i vjetër, por, në të vërtetë, fotot tregojnë një grua që jeton si mashkull në Veri të Shqipërisë.

Fotot janë realizuar nga fotografi spanjoll Luis Dafos, i cili ka marrë shkas nga historia e burrneshave për një reportazh të veçantë. Të quajtura ndryshe edhe si “Virgjëreshat e betuara”, burrneshat presin flokët shkurt, vishen me rroba meshkujsh dhe marrin përsipër përgjegjësitë e burrit. Ndryshe nga femrat e tjera, burrneshat lejohet të pinë cigare, alkool, të mbajnë armë dhe të krijojnë lidhje shoqërore me burrat e tjerë. Spanjoli Luis Dafos shkruan: “Në një familje ku nuk kanë mbetur më burra, një nga femrat nis të sillet si i tillë për t’u bërë kreu i ri i familjes dhe për t’i dalë zot familjarëve”.

Fotografi ka biseduar me 92-vjeçaren Qamile Stema, e cila ka jetuar si burrneshë që në moshën 20-vjeçare. Ajo ka treguar se kjo ishte e vetmja mënyrë për të trashëguar tokën e familjes së saj dhe për të mbrojtur 9 motrat më të vogla pas vdekjes së babait. Qamilja është burrneshë e fundit në fshatin Baraganesh.

“Mendoj se gjithmonë kam qenë edhe grua, edhe burrë”, thotë Qamilja.

Femrat i kanë fshehur talentet e tyre që të shpëtojnë krenarinë e meshkujve.

Ky fenomen është shumë i njohur në të gjithë Veriun, pra është i pranishëm edhe në Veriun e Kosovës. Mua më ka zgjuar shumë kureshtje ky fenomen. Kam hulumtuar gjithkund ku mundesha mbi këtë fenomen e shpesh pyesja tim atë për historitë e vjetra të kulturës së vendit tim, bëhesha kureshtare gjithmonë se çfarë kishte ndodhur me gruan gjatë gjithë kësaj kohe. Si do të shkolloheshin ato, përse regjimi ynë nuk i lejonte të shkolloheshin të gjithë... Shumë e interesuar drejt çështjes, ndërkohë që shpesh kam dashur të jap një pjesë të mirë të feminitetit dhe të karakterit të fortë të gruas, që sfidon meshkujt, për t'ia dalë mbanë vetë në jetë prandaj kjo temë më është dukur interesante. Në optikën botërore, sigurisht kjo është një temë joindiferente, por mahnitëse për arkaizmin e saj të mbartur prej shekujsh si një traditë, tashmë për ta shpënë në muze historik.

Një tmerr i vërtetë, brenda këtij fenomeni, është se sa më thellë t'i shkosh aq më shumë dashuron faktin e të qenët grua, universaliteti i saj të lë me gojë të hapur. Ajo që e bën këtë traditë tonën të bukur është pikërisht motivi i lirisë dhe kultit i nderit. Këto gra, që bëjnë këtë sakrificë, *në këmbim të lirisë nderohen dhe pranohen si të barabarta me burrat*. Përderisa në botë këto zgjedhje bëhen për motive të ndryshme përsëri gjykohen e paragjykohen edhe pse ikja nga gjinia natyrale ka motive të lirisë dhe të shprehjes seksuale. Nga ana tjetër këtë motiv e kemi të ndaluar te “Burrneshat”, gjë që e bën të nderohet dhe të arrijë një kult të nderit në shoqëri. Është një burim i

pashtershëm trajtimi i kësaj teme. Gruaja duhet të jetë e dëlirë, dhe për ta arritur këtë në mentalitetin shqiptar është e domosdoshme që gruaja shqiptare të njihet deri në detaje, sepse ende bota e saj është e pazbuluar. Jemi popull që kemi mbetur, në mënyrë shumë të dukshme, prapa nga popujt e tjerë të Europës edhe pse luftojmë fort për të qenë midis tyre e sidomos zonat e thella të Veriut, ku ende zotërojnë struktura arkaike zakonore. Kjo e bën realitetin tonë me interes për kineastët e huaj apo për studiuesit, sepse te ne ata shohin njëfarë rezervati ku qëndrojnë të konservuara e kaluara dhe e vjetruara.

Bota shprehet se ne jemi një thesar i pazbuluar ende për nga vjetërsia si komb, për kulturën tonë, për traditat, për jetesën e femrave në veçanti. Vëmendje i ka kushtuar edhe shkrimtarja, Antonia Jongu, antropologe dhe autore e librit “Gratë që bëhen burra”, e cila në pjesën “Virgjëreshat shqiptare të betuara” shpjegon se Patriarkana shqiptare nuk e lejon që një grua të marrë përsipër të kujdeset për familjen, por kur të gjithë burrat e familjes kanë vdekur dhe në familje ka vetëm gra, njëra prej tyre do të vendosë që të mbetet e virgjër dhe e pamartuar përgjithnjë, duke u bërë kështu kreu i ri i familjes. Ose në rastin kur vajzat janë shumë të reja, prindërit e tyre, që nuk kanë djem, do të vendosin për to. Jongu shpjegon se vajza e betuar do të sillet dhe do të vishet si djalë, e detyruar të veprojë si një burrë, të bisedojë me djem dhe me burra të tjerë. Ajo (ai) duhet të kujdeset e të punojë tokën bujqësore, madje edhe të mbajë një armë.

“Virgjëreshave të betuara” kurrë nuk u lejohet të kthehen në gra, kjo ngaqë thyerja e betimit ose e amanetit të të parëve dënohet me vdekje. Më tej antropologia Jongu shton se “Porosia e Lashtë”, e cila tani po zhduket, ka zgjatur gati 200 vjet. Ajo ishte një traditë e fortë në Shqipëri dhe deri diku edhe në Mal të Zi e në Kosovë. Me rënien e komunizmit, pas viteve 1991, “Virgjëreshat e betuara” janë një fenomen i rrallë në Shqipëri. Praktika ka lindur nga ligji tradicional i shqiptarëve të veriut. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, thoshte se *gratë u përkisnin etërve të tyre derisa martoheshin dhe më pas ato bëhen pronë e burrave të tyre*. Njëkohësisht duke u bërë “Virgjëresha të betuara” ato u shpëtonin martesave të padëshiruara. Jongu thotë se kjo praktikë u dha grave pavarësinë, por edhe të drejtën për të kryesuar familjen dhe për të mbajtur pasurinë, e cila përndryshe do të merrej nga një mashkull tjetër i fisit.

Një grua mund të bëhet “burrneshë” vetëm në një nga këto tri raste: kur familja nuk ka trashëgimtar mashkull dhe e di që kurrë s’do të ketë; kur djali ose burri i vetëm i shtëpisë vdes në luftë dhe kur ajo refuzon të martohet me burrin që i ka gjetur familja e saj. Në fund gazeta shkruan se në Shqipëri ky fenomen pranohet ende si një normë sociale. Nuk është hera e parë që fenomeni verior në zhdukje i “burrneshave”, në Shqipëri, tërheq vëmendjen e mediave botërore. Pak vite më parë ishte prestigjiozja amerikane “The New York Times” ajo që i kushtonte një hapësirë mjaft të madhe këtij fenomeni që e ka origjinën nga *Kanuni i Lekë Dukagjinit*.

1.3. GRA QË KANË BËRË HISTORI NË KOHË TË NDRYSHME

Mendimet e shpeshta në vrapin e rrugëve dhe të jetës janë ato që më karakterizojnë - vetëm vrapoj, nuk eci dot se hapat më duken të ngadaltë - më kanë bërë që gjithmonë të marr përsipër shumë punë njëherësh... me sa duket jam produktive kështu e jo duke i marrë gjërat një nga një. Edhe punët e shtëpisë, kur nis t'i bëj, i nis të gjitha përnjëherë e më pas dua t'i mbaroj të gjitha po përnjëherë. Në vrapin tim kam qenë në kërkim të fillimit të një "luftë" të grave në Shqipëri. Kam kërkuar gratë e modeleve, të cilat kanë pasur guximin të sfidojnë kohën dhe mendimet e patundura. Në kërkim të grave, që kanë thyer tabutë shumë strikte, për të hapur rrugën për të ardhmen, kërkoj ato që kanë vendosur në vend mbi çdo gjë.

Do të flas për disa gra, gra heroina, të pavdekshme, të cilat dhanë kontributin e tyre të vlefshëm jo vetëm duke luftuar dhe duke u përpjekur për të çliruar vendin e tyre, por në të njëjtën kohë vunë themelet dhe hapën rrugën për gratë e civilizuara. Këto gra kanë jetuar dhe punuar në periudha të ndryshme historike, kanë treguar guxim në tabutë që kanë thyer për fshirjen e varfërisë e injorancës. Unë do të filloj

me mbretëreshën ilire, Teutën, me Donika Kastriotin, me Elena Lukrecian, Nora Kelmendin, me Tringa Grudën, Dora d'Istrian, Dhaskarina Bubulinën, Motrat Qirjazi, Paro Kitën, Urani Rumbon, Marie Çobën, Shote Galicën, Santa Angjelinën dhe sidomos me Nënë e botës: të Shenjtën Nënë Tereza.

Aktiviteti i grave të famshme shqiptare është i lidhur ngushtë me rrethanat në të cilat ajo është lindur, ka jetuar dhe vepruar populli shqiptar. Si pasojë, është më se e nevojshme për një kthim të shpejtë në të kaluarën. Natyrisht ndjenja e përkatësisë etnike dhe robëria e gjatë kanë ndihmuar për të krijuar një logjikë rezistence të vazhdueshme të popullit shqiptar ndaj pushtuesve të ndryshëm. Në themel të kësaj rezistence është gjithmonë gruaja, është ajo që ka punuar për edukimin e brezit të ri; arsimit ka filluar nga nullohet e para, kur brezat u mëkuan me dëshirën për liri dhe me respektin për vlerat kombëtare dhe njerëzore. Për këtë arsye, gjatë viteve meritat e grave shqiptare kanë zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm e të veçantë. Meritat e tyre i njeh dhe *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, një nga kodet zakonore të ligjit të vjetër në Europë. Sipas kanunit, ajo ka gëzuar të drejtën për të marrë pjesë në mbledhje dhe si rezultat ka qenë në poste të rëndësishme, nga të cilat ka mundur të marrë vendime. Mbijetesa e këtij kanuni ndër vite dhe përdorimi i tij në vazhdimësi nga disa, konsiderohet si pasojë e rezistencës ndaj ligjeve të pushtuesve, të cilët janë përpjekur të depërtojnë te populli shqiptar.

Të mësosh një burrë për të mbjellë një pemë do të thotë të mbjellësh pemën vetëm për hije, ndërsa të mësosh një grua të mbjellë një pemë përveçse bën hije, jep dhe fruta.

Sami Frashëri

Në historinë mijëvjeçare të njerëzimit, për fat të keq, janë pak gra që kanë dalluar në fusha të ndryshme dhe ato kanë qenë të suksesshme për shkak se kanë zëvendësuar ose kanë mbështetur njerëz të famshëm. Shumë gra kanë mbetur anonim dhe janë identifikuar me emëruesin e përbashkët të “gruas”. Bota e izoluar e grave edhe pse e mbushur me aktivitet e kreativitet, filloi të hapet vetëm nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë. Në shekujt në vijim, falë këmbënguljes individuale të tyre, filloi të shpërthejë energjia e tyre krijuese. Fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë shënon inkadrimin e grave në të gjitha sferat e shoqërisë, sidomos në ato vende ku ishte e mundur për të marrë vendime, gjë që pasuroi trashëgiminë e çmuar të njerëzimit.

Natyrisht, kjo fazë e historisë ka prekur edhe gratë shqiptare. Duke pasur parasysh ulje-ngritjet e historisë së popullit shqiptar, ne duhet të pranojmë se ka shumë gra që e meritojnë të jenë të njohura më mirë se ata burra që ishin shtyllat e familjes dhe kombit. Ashtu si pamja e gruas shqiptare në sytë e Margaret Jursenal-it. Ajo shkruan: *Unë do të doja një grua shqiptare, si një nënë!...* dhe nuk është rastësi që nga barku ynë doli dhe u rrit më e madhja e Nënave në botë sot, e Shenjtë Nënë Tereza.

Këmbëngulja dhe sakrifica ishin gjithmonë të pranishme, sipas burimeve historike, si një formë e rezistencës së grave shqiptare në luftën për liri dhe pavarësi. Kanë qenë ato që u kanë rezistuar përpjekjeve të asimilimit nëpër vendet ku jetonin, duke përfshirë kulturën, mësimin dhe kultivimin e arsimit të lashtë patriotik, njerëzor, familjar dhe popullor të traditës krijuese.

Falë bashkimit të grave shqiptare, që rezistuan dhe vepruan në rrethana dhe kohë të vështira, kanë lindur personalitete të njohura, veprat e të cilave kanë tejkaluar kufijtë e diktuar nga seksi dhe nga kombet. Ato kanë treguar se truri nuk varet nga seksi dhe me veprat e tyre kanë zbuluar se nuk ka forcë që mund të ndalojë një popull dhe dëshirën e tij për vetëvendosje, emancipim global dhe barazi gjinore.

Shekulli i pesëmbëdhjetë, periudha e një rëndësie të madhe për Europën Perëndimore që përkon me periudhën kur Europa Lindore pushtohet nga osmanët, pushtim që zgjati pesëqind vjet, tregoi se shqiptarët i rezistuan këtij pushtimi, sepse ishin futur, së bashku me parimet e tyre, brenda koalicioneve të krishtera që luftonin kundër osmanëve. Shqiptarët, të udhëhequr nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu, bënë rezistencë të fortë kundër pushtimit turk dhe u bë një mur i pakalueshëm për Perandorinë Osmane në Europë. Por pak është folur për faktin se Skënderbeu u mbështet fuqimisht nga gruaja e tij, Donika Kastrioti, e cila ishte personi më i afërt për të në politikë dhe në çështje të tjera. Ajo ishte e drejtë dhe krahu i

djathtë i Gjergjit. Për fat të keq edhe Skënderbeu nuk arriti të ndalonte pushtimin famëkeq të osmanëve në Perëndim. Luftërat antiosmane vazhduan deri në rënien përfundimtare të Perandorisë Osmane...

Tringa Gruda luftoi deri në frymën e fundit kundër pushtuesve turq dhe nuk e hoqi armën. Ajo luftoi kundër shtypjes në tokën e saj. Me një intuitë të hollë prej gruaje, ajo e kuptoi se pa arsimimin e grave nuk mund ta fitonin luftën me pushtuesit, se vetëm me arsimim mund ta mbanin të gjallë historinë, gjuhën dhe zakonet e një populli. Dhe kështu në vitet 1916-1917, ajo sakrifikoï pasurinë e saj duke bërë të mundur hapjen e shkollave shqipe në rajonin e Malësisë së Madhe. Aktiviteti i saj dhe kontributi i saj për pavarësinë e Shqipërisë, janë përmendur edhe në histori dhe në letërsinë shqiptare. Për të flitet si një grua e guximshme. Në veprën e famshme të Gjergj Fishtës, të titulluar “Lahuta e Malësisë”, Tringa është një nga emrat më të njohur në rajonin e Malësisë - bija trime e maleve që e urrente shtypësin dhe ishte gjithnjë stoike në rezistencën e saj për të sulmuar pushtuesit otomanë.

Nora e Kelmendit u bë pjesë e historisë së Shqipërisë. Si një legjendë, një grua luftarake, veçanërisht në frontin e Pashait turk, që u vra nga vetë ajo. Nora u bë krenaria dhe simboli i rezistencës së gruas shqiptare për pavarësinë e vendit.

Luftëra të ngjashme dhe të organizuara pati edhe në Greqi, ku grua ja më e famshme arvanitase, e njohur në historinë greke, Dhaskalina Pinoce-

Bubulina (1821), luftoi së bashku me shqiptarë të tjerë për të liruar Greqinë. Bubulina ishte kapitenia e anijes dhe në të njëjtën kohë një stratege e talentuar, që ia kushtoi tërë jetën dhe pasurinë e saj luftës kundër pushtuesve osmanë, me shpresën e kthimit të lirisë në vendin e saj. Falë inteligjencës, urtësisë dhe trimërisë, Bubulina u bë një nga heroinat më të famshme të historisë greke, kështu ajo la gjurmë në historinë e Greqisë dhe në atë të Shqipërisë.

Për fat të keq, shkatërrimi i Perandorisë Osmane nuk ia garantoi lirinë mbarë popullit shqiptar, sepse vendimet e gabuara, të hartuara në Konferencën e Ambasadorëve në Londër lanë gjysmën e popullit shqiptar jashtë kufijve të kombit, duke e detyruar këtë pjesë të popullsisë që të vazhdonte luftën kundër pushtimit serb dhe grek. Nora e Kelmendit u bë pjesë e historisë së Shqipërisë. Si një legjendë, një grua luftarake, veçanërisht në frontin e Pashait turk, që u vra nga vetë ajo. Nora u bë krenaria dhe simboli i rezistencës së gruas shqiptare për pavarësinë e vendit.

Shote Galica u bë figura më karizmatike e lëvizjes Kaçake në Kosovë dhe pas vdekjes së burrit të saj ajo ishte udhëheqëse në luftën për çlirim.

Të vetëdijshëm për rolin e rëndësishëm të grave në edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja, pushtuesit turq, serbë apo grekë kanë penguar me mënyra nga më të ndryshme dëshirën për pavarësi dhe emancipimin e gruas shqiptare. Ata, për të ndaluar luftën e tyre, kanë përdorur metodat më poshtëruese si: vrasje, deportim, burgim, mallkim apo refuzim

nga ana e kishës, e në raste më makabre përdhunimin. Megjithatë, lufta për emancipimin e gruas shqiptare ka vazhduar gjithmonë. Lidhur me këtë është interesante të lexosh atë që është shkruar nga mësuesi zviceran, Venera Pfeninger, i cili mësoi në Institutin “Kyrias” të Motrave Qirjazi, në vitet 1928-1930: *Institucioni “Kyrias” ka shërbyer si kyç për historinë e vendit, historinë e Shqipërisë së pushtuar nga rrymat; Veri, Lindje, Jug dhe Perëndim.*

Duke dëgjuar studentët tanë... Kam kuptuar se për shkak të karakterit të tyre të fortë dhe vendosmërisë kanë arritur t'i rezistojnë tundimeve të liga dhe kozmopolitanizmit që pastron dhe njerëzit e deformuar...

Sevasti Qirjazi ka hyrë në listën e zezë të grekëve, të cilët dëshironin ta eliminonin atë. Tome Gjyshja shkruan: *e para e shkollës laike, Kushe Mica shqiptare, është bërë e njohur edhe në Shkodër.* Por ne nuk duhet të harrojmë Marie Çobën, intelektuale dhe patriote, që ka dhënë një kontribut të madh në emancipimin dhe integrimin e grave shqiptare në shoqëri.

Të gjitha këto gra - Nora, Tringa, Parashqevia, Shota, etj. - janë shqiptare, kanë lindur dhe kanë luftuar së bashku me burra të guximshëm, duke dhënë lavdi dhe nder për atdheun e tyre dhe duke u bërë një model për brezat e ardhshëm, një shembull i heroizmit dhe krenarisë. Një letër e nënshkruar nga 300 nxënës të shkollave të ndryshme të Shkodrës në 1881-in, me një stilolaps argjendi që e dhuroi Elena

Gjika (Dora d'Istria), tregon mirënjohjen e ndjerë për atë që ajo bëri në Shqipëri dhe janë dëshmitarë për kulturën dhe humanizmin e një patriotije, e cila qysh në vitin 1866 parashikoi pavarësinë dhe ne sot pa frikë mund ta quajmë një ndriçuese të feminizmit botëror. Ajo mbetet një nga gratë më të famshme të shekullit të XIX, shkrintare, shkencëtare, publiciste, patriote dhe diplomate; përqafoi kauzën e shqiptarëve duke u përpjekur të sensibilizojë arenën botërore në një moment veçanërisht të vështirë për kombin tonë që rrezikonte copëtimin.

Elena Gjika botoi disa artikuj dhe studime të tilla si “Kombësia Shqiptare sipas këngëve popullore” dhe “Shqiptarët e të dyja anëve të Adriatikut” ku ka argumentuar ekzistencën dhe historinë e vendit tonë, lashtësinë e popullit shqiptar, trashëgiminë kulturore e artistike, literaturën e pasur gojore, folklorike, veshjet e rralla dhe unike tradicionale të të gjitha trevave shqiptare.

Dora d'Istria ka shkruar: *Populli shqiptar, një nga më të vjetrit në Europë, e meriton të jetë i lirë në mënyrë që të mund të zhvillojë kreativitetin e tij.*

I nderuar dhe i dashur Z. Geronimo, Atdheu im i nderuar është Arbëria dhe atë do ta takoj në fund të jetës sime...

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i kontributit të çmuar nga Elena Gjika në enciklopedinë për formimin e identitetit kombëtar shqiptar janë kontaktet dhe marrëdhëniet e mbajtura me intelektualët dhe

patriotët arbëreshë, pasi familja e Dorës kishte lëvizur në Itali shekuj më parë. Për të është shkruar shumë nga filozofë, sociologë, antropologë, shkrimtarë etj., e cila, që në moshën 11-vjeçare krijoi librat e parë. Ndër marrëdhëniet e saj më të rëndësishme janë ato me Dhimitër Kamardën dhe me Jeronim de Radën.

Dora ishte shumë popullore në qarqet intelektuale të epokës kulturore dhe një mbështetëse e fortë e shqiptarëve të Rilindjes. Ajo kishte arritur të fitonte respektin dhe vlerësimin e një luftëtari të lirisë si Garibaldi, me të cilin pati një marrëdhënie shumë interesante. Miqësia e saj me Garibaldin ishte aq e thellë sa ai e quajti “Motra e guximshme” dhe bashkëpunimi i tyre u forcua shumë në të mirën e çështjes shqiptare.

Një tjetër fakt pro grave, dhe që pati rëndësi të veçantë për gratë shqiptare, ishte Lidhja e Prizrenit, sepse aty janë njohur vlerat dhe meritat e gruas shqiptare, por dhe roli i saj në shoqërinë njerëzore. Lidhja hapi shkolla për kaq shumë vajza, hapi “Shkolla e Vashave” në Korçë, e themeluar nga motrat Sevasti dhe Parashqevi Qirjazi, e pasuar nga hapja e shkollave në qytete të tjera të Shqipërisë, si në Shkodër, në Tiranë, në Elbasan, në Prizren e të tjera. Në këto shkolla u edukuan vajza të feve të ndryshme.

Ky dhe fakte të tjera, në lidhje me punën e grave, si edhe ndihma që dhanë së bashku me burrat gjatë viteve të Rilindjes Kombëtare, dëshmojnë qartë për përkushtimin e treguar prej tyre. Gratë ofruan ndihmë gjatë luftës për pavarësi, për ta lënë

errësirën e Mesjetës, për të blerë lirinë, arsimin dhe dijen. Nxënësit dhe mësuesit e shkollave të vajzave shqiptare janë bërë aktivistë të palodhur të Rilindjes Kombëtare, duke mbështetur luftëtarët e lirisë, duke luftuar me ta dhe duke sakrifikuar çdo gjë si dhe rininë e tyre për t'u bërë pjesë e historisë.

Në vitin 1911 flamuri i qëndisur nga Marigo Posio është dorëzuar për heroin tonë, babain e kombit - Ismail Qemali, i cili e ngriti atë më 28 nëntor 1912. Këto gra kanë dhënë gjithë atë mund edhe në kushte të vështira, në një periudhë të karakterizuar nga konservatorizmi, prapambetja, injoranca, mungesa e kulturës dhe analfabetizmi. Nëse do të shfletoni faqet e shtypit të kësaj periudhe menjëherë do të vini re dëshirën për ndërtim, dëshirë që ka karakterizuar femrat shqiptare, vrapuesit për maratonën e çlirimit dhe pavarësinë e vërtetë. Gjithashtu, duket shumë qartë se problemet që kanë ngjallur shqetësim në gjirin e grave, të cilat nuk ishin njohur me të drejtat dhe lirinë e tyre, duke luftuar kundër zakoneve të vjetra, që nuk ishin asgjë më shumë se sa pjesë patriarkale që ia la trashëgim pushtuesi turk shoqërisë shqiptare.

Duhet theksuar se pavarësisht kufizimeve gjeografike, përpjekjet e organizimit të grave në Shqipëri, si pjesë e intelektualëve të para shqiptare, kanë pasur një rëndësi të madhe. Ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në progresin e vendit për të dalë nga prapambetja dhe shoqatat e grave kanë shërbyer si një vend takimi për anëtarët dhe mbështetësit. Në këto qendra janë shfaqur elementet e një shoqërie

demokratike. Atje, gratë dhe vajzat kanë mësuar se çfarë do të thoshte të kesh të drejtë për votim të fshehtë për zgjedhjen e organeve drejtuese dhe të përfshihesh në jetën politike të vendit, një e drejtë që u mohua nga qeveritë e kësaj periudhe. Pavarësisht nga vështirësitë dhe pengesat, lëvizja feministe e kësaj periudhe ka përfaqësuar një bazë të rëndësishme në të cilën ajo ka zhvilluar dhe organizuar lëvizjen feministe shqiptare në vitet në vijim.

Do të zgjedh të flas më specifikisht për disa nga heroinat e Shqipërisë, të cilat i njohin shumë prej nesh, por i harrojmë pa dashur nga dyndja e madhe e meshkujve me sukseset e tyre.

Nënë Tereza

Një hapësirë e veçantë i takon GRUAS MË TË FAMSHME NË BOTË dhe ajo për fatin tonë të mirë është shqiptare. Shqiptarja trupvogël u kthye në një legjendë të gjallë! U shndërrua në Nënë kujdestare të 7500 fëmijëve në 60 shkolla; Nëna që mjekonte 960,000 të sëmurë në 213 dispanseri... Ishte e vetmja në botë që trajtonte 47,000 viktima të lebrozës në 54 klinika; kujdesej për 3,400 pleq të braktisur e të lënë rrugëve, në 20 shtëpi pleqsh... Kishte birësuar 160 fëmijë ilegjitimë e bonjakë. (Këto janë shifrat e mesit të viteve 80-të). Derisa Nënë Tereza ishte gjallë dhe sot e kësaj dite shifrat kanë ndryshuar shumë. “Nënë Tereza e Kalkutës” u quajt kur themeloi urdhrin “Misionaret e Dashurisë” (1951) për t’u shërbyer më të varfërve.

Quhej Anjezë Gonxhe Bojaxhiu. Lindi në Shkup të Maqedonisë, më 26 gusht të vitit 1910 dhe vdiq më 5 shtator të 1997-ës në Kalkutë (Indi). Mbetet humanistja e njohur shqiptare e bekuar nga Vatikani. Nënë Tereza u bë një nga urat ndërlihdhëse të njohjes së shqiptarëve në botë.

Nënë Tereza, ishte e para ajo që më bëri ta dua kombin shqiptar. Dhe tani ndihem shumë krenar që plotësova një detyrë morale ndaj saj dhe ndaj vlerave të lirisë.

Bill Clinton

Nënë Tereza u pagëzua në kishën e Zemrës së Krishtit nga famullitari i atëhershëm Dom Zef Ramaj, ditë të cilën ajo e quan si ditëlindjen e saj. Gonxhja ishte fëmija i tretë i Kolë Bojaxhiut me origjinë nga Mirdita dhe e Drane Bojaxhiut (mbiemri i vajzërisë Barnaj) nga Novo Sella e Gjakovës. Kola dhe Drania patën 5 fëmijë, dy nga të cilët u vdiqën në fëmijërinë e hershme. Frikë të madhe kishte nënë Drania se mos Gonxhja i vdiste menjëherë pas lindjes, sepse me trup dhe shëndet dukej e dobët. Gonxhja kishte një vëlla dhe një motër. Vëllai, Lazër Bojaxhiu, studioi në Grac të Austrisë në Akademinë Ushtarake, por për shkaqe politike emigroi qysh herët në Itali, kurse e motra quhej Age Bojaxhiu. Babai i saj merrej me tregti dhe mblidhte në shtëpinë e tij artistë dhe patriotë shqiptarë. Gonxhja mësimet e para i mori në një shkollë shqipe në Shkup, ku po ashtu kreu

dhe gjimnazin, por në gjuhën serbo-kroate. Pasionet e rinisë së Gonxhes ishin tre: të bëhej mësuese, të shkruante dhe të recitonte poezi, të kompozonte e të luante muzikë. Emrin “Tereza” e mori kur ishte 18 vjeçe dhe u dorëzua murgeshë.

Në vitin 1979, kur mori Çmimin *Nobel për Paqe* e gjithë bota mësoi se Nënë Tereza ishte shqiptare. Shkrimet e saj në shqip janë letrat e rinisë dhe më pas korrespondenca me familjen e saj. Përshëndetja në shqip e popullit shqiptar pas fitimit të çmimit *Nobel* si dhe lutja në shqip, transmetuar nga Zëri i Amerikës më 17 qershor 1978, ishin emocion bote dhe lot gëzimi për ne si komb, në të njëjtin moment.

Kam lindur në Shkup, jam shkolluar në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në Botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri.

Nënë Tereza

Shtëpinë e Nënë Terezës e kanë vizituar personalitete si mbretëresha e Britanisë, ish-presidentët e Shteteve të Bashkuara, George Bush e Jimmy Carter, Yasser Arafat, princesha Diana e shumë të tjerë. Ndër titujt që i janë dhënë Nënë Terezës përmenden: *Pamada Shir, Gjoni XXIII për Paqe*, të cilën ia dorëzoi personalisht Papa Gjon Pali VI, *Samaritani i Mirë* në Boston; *Shpërblimi Ndërkombëtar John Kennedy* në Uashington; *Nëna e të Gjitha Nënave*, Balzan; Çmimi *Nobel për Paqen, Medalja e Lirisë* - shpërblimi më

i lartë amerikan; *Medalja e Paqes* - shpërblimi më i lartë i Rusisë etj. Nënë Tereza ka qenë mjaft bujare, humane e zemërgjerë dhe këto janë karakteristikat që do ta bëjnë të jetojë përgjithmonë në zemrat e gjithë njerëzve, sidomos në zemrat e shqiptarëve. Gonxhja u bë qytetarja e botës e popujve, e feve dhe e qytetërimeve. Të shkruash për të asnjëherë nuk mjafton

Mbretëresha ilire Teuta

A ishte kjo gruaja e parë e vendit tonë? Mendoj se e zgjodha për ta ndarë me ju, meqenëse kemi një mbretëreshë, por ende s'kemi një presidente. Sipas të dhënave historike, Teuta ishte mbretëresha ilire, që mëkëmbësoi të shoqin, Agronin, në vitin 231 p.e.s. Teuta si gruaja e parë tutore (kujdestare), njerka e Pinit, birit të rritur të Agronit (që e kishte me gruan e dytë), u vu në krye të shtetit ilir e të ushtrisë, duke mbretëruar e komanduar në vitet 230-228 p.e.s. Teuta qe një personalitet i rëndësishëm i historisë Ilire. Sundoi vetëm për 3 vjet, por vepra dhe lavdia e kësaj gruaje ka triumfuar në shekuj. Ajo mori pushtetin në një moment të vështirë për popujt ilirë, e veçanërisht fisin Ardian, të cilët përballeshin me ambiciet për zgjerim të Mbretërisë Romake, paçka se gjendja ekonomike e zotërimeve të mbretëreshës ishte e mirë. E denjë për të pasuar burrin e saj, Agronin, vijoi me planet dhe synimet e tij, përforcoi me tej rendin shtetëror; e duke i dhënë përparësi pushtetit qendror

i dha impuls të ri zhvillimit ekonomikokulturor të qyteteve si bazë themelore për një stabilitet dhe fuqizim në fushën ushtarake. Bëri kujdes që të mos cenoheshin kufijtë e mëparshëm të mbretërisë (që shtriheshin nga Vjosa në Naron, përveç Durrësit, Apolonisë dhe Lezhës, që ende mbaheshin si koloni nga romakët). Vëmendjen kryesore ia kushtoi ushtrisë dhe sidomos flotës së fuqishme detare, jo më të vogël sesa ajo para saj.

Sipas historianëve, mbretëreshë Teuta ka pasur karakter të fortë, kishte cilësi të një gruaje mjaft të zgjuar dhe me largpamësi objektive, ishte ky karakter dhe këto cilësi që ajo nuk pëlqej shumë nga shtetet fqinje. Me një nuhatje të mirë për armikun, ajo ndërmori dhe realizoi një veprimtari të gjithanshme politike, ushtarake e diplomatike. Mbretëreshë Teuta u përpoq të afronte aleatë (siç ishte formimi i marrëdhënieve me Maqedoninë) për të përballuar opozitën e brendshme dhe kërcënimet e jashtme. Ndërkohë edhe strategjikisht, ajo punoi për të zbutur armiqësitë e mbretërve të veçuar dhe përgjithësisht, për të shuar rivalitetet e grupeve shoqërore të armatosura brenda mbretërisë. Me këtë vijë dinamike dhe elastike, mbretëresha-stratege e rriti prestigjin, shëndoshi pozitën në gadishull dhe Adriatik e përgatiti terrenin e opinionin për hapa dhe aksione të reja. Kishte një shpirt shumë frymëzues, komandoi me sukses ushtrinë dhe flotën. Kryeqyteti

epiriot, Foinika (Finiqi i sotëm, afër Sarandës), që dallohej si më i pasuri midis qyteteve të Epirit, ra në duart e ushtrisë ardiane.

Historia e saj është akoma më e gjatë dhe shumë e bukur, por nuk do të doja ta ktheja shkrimin në një enciklopedi, megjithatë vlen për të parë se sa bukur sundojmë ne femrat, si i analizojmë ngjarjet nga ana psikologjike dhe sigurisht gjithmonë jemi pre e emocioneve të furishme, por s'mundemi pa to.

Donika Kastrioti

E përndritura zonjë, porsinanë e dashur e quajti Mbreti i Napolit, Ferdinandi. Zonja e parë e Arbërit, Andronika (Donika) Kastrioti ishte gruaja e Skënderbeut. Ajo ishte bija e princit të famshëm Gjergj Arianiti, njërit prej prijësve më të mëdhenj të luftës kundër pushtimit osman. Andronika ishte një dukeshë. Ajo lidhi kurorë me Gjergj Kastriotin, kryekapedanin e Lidhjes Shqiptare, pothuaj një mbret pa kurorë dhe u bë princeshë. Në gjuhën e sotme protokollare Andronika Kastrioti ishte gruaja e parë e Arbërisë. Andronika lindi në Kaninë, më 1428. Ky vit i lindjes së saj del nga shumë të dhëna të historianëve të ndryshëm, të cilët thonë se ajo ka qenë 23 vjeçe kur u martua me Skënderbeun. Martesa u bë në vitin 1451 dhe Skënderbeu ishte sa dyfishi i saj në moshë, 46 vjeç. Pas kësaj martese Donika do të bëhej një simbol shekullor i gruas shqiptare.